

RAPORTI FINAL

UNIVERSITETI I GJAKOVËS

Akreditimi Institucional dhe i Programeve

16-17 Prill 2014

Tabela e Përmbajtjeve

1. Përmbledhje	2
2. Raporti institucional.....	5
i. Deklarata e Misionit	
ii. Organizimi dhe Udhëheqja	
iii. Stafi	
iv. Financat	
v. Plani për Zhvillim	
vi. Menagjimi i Cilësisë	
vii. Ndërkombëtarizimi	
3. Raportet në Programet e Studimit.....	13
i. Bachelor në Gjuhë Shqipe – shih dokumentet shtesë	
ii. Bachelor në Letërsi Shqipe – shih dokumentet shtesë	
iii. Bachelor në Edukim Parashkollor	
iv. Bachelor në Edukim FILLOR	
v. Bachelor në Infermieri	
vi. Bachelor në Mami	
vii. Bachelor në Fizioterapi	
viii. Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze	

1. Përmbledhje

Agjensionit i Kosovës për Akreditim (AKA) i është caktuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të vlerësoje të gjitha institucionet e Arsimit të Lartë të cilët veprojnë në Republikën e Kosovës. Bazuar në këtë kërkesë, Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" iu nënshtrua procesit të Akreditimit në prill të vitit 2014. Është ndërmarrë një rishqyrtim i plotë institucional, dhe një numër i programeve të studimit është vlerësuar nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë (EE). Anëtarët e EE ishin:

- Prof. Dr. Philip Coleman (Trinity College, University of Dublin, Ireland)
- Prof. Dr. Milan Pol (Masaryk University, Czech Republic)
- Prof. Dr. Shezai Rrokaj (University of Tirana, Albania)
- Prof. Dr. Danica Železnik (Univ. College of Health Sciences Slov. Gradec, Slovenia)

EE i është mirënjohës Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" për mirëpritjen gjatë vizitës së tyre më datat 16 dhe 17 prill 2014. EE është i vetëdijshëm për gjendjen historike që vazhdon të prekë ambientin bashkëkohor shoqëror, kulturor, politik dhe ekonomik në Kosovë. Kështuqë, EE vlerëson përpjekjet e vazhdueshme të menagjmentit, stafit akademik dhe studentëve të Universitetit të Gjakovës për të zhvilluar cilësinë e burimeve dhe programeve të mësimit brenda këtyre rrethanave të vështira locale dhe kombëtare.

Qeveria e Kosovës themeloi Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" nën dekretin numër 02/118 në mars 2013 dhe Parlamenti i Kosovës miratoi dekretin në muajin maj të të njejtit vit. Universiteti i Gjakovës filloi operimin më 1 tetor 2013 me një Departament të Edukimit, programe në Edukim Fillor dhe Parashkollor, një Departament të Mjekësisë me programe në Infermieri dhe Mami, dhe një Departament Filologjik me programe në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe si dhe Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Këto programe u akredituan nga AKA në prill 2013. Universiteti dukshëm po bën hapa për t'iu përgjigjur pozitivisht vlerësimeve paraprake, the version i fundit i Raportit të tij të Vetë-Vlerësimit (RVV, 2013) përmban tabela, diagrame, dhe shpjegime të detajuara që shprehin përkushtimin e tij për një zhvillim pozitiv. Ky dokument ishte shumë i dobishëm për EE gjatë vizitës në institucion dhe përgatitjes së këtij raporti.

EE kupton pozicionin e Universitetit të Gjakovës në tregun e Kosovës për të ofruar arsimim të nivelit të tretë. EE dëshiron të theksojë se të gjitha komentet e cekura në këtë raport kanë për qëllim vetëm të kontribuojnë në zhvillimin e mëtutjeshëm të institucionit përgjatë përpelitjeve për ta arritur misionin e tij, që është "rritja e avantazheve konkurruese dhe nivelit të arsimimit në Kosovë dhe regjion, veçanërisht në arsim, mjekësi, ekonomi, administratim dhe fusha të tjera që do ndihmojnë këtë drejtim."

Anëtarët e EE duan ta falenderojnë AKA-në dhe veçanërisht Z.Basri Mija, Znjsh, Furtuna Mehmeti dhe Prof.Dr. Ferdija Zhushi Etemi për mikëpritjet e tyre, mbështetjen dhe bashkëpunimin gjatë procedurave të akreditimit. Z.Muja dhe Znj.Zhushi-Etemi shoqëruan EE në të gjitha vizitat e tyre në institucion.

Procesi i vrojtimit u bazua nga dokumenti udhëzues i AKA-së për Standardet e Akreditimit, i cili i është dhënë ekspertëve para vizitës në institucion. Dokumenti përkatës i dhënë ekspertëve përfshinte Udhëzimet për Ekspertët në Programet Akadematike, Udhëzimet për Ekspertët në Programe Institucionale dhe Kodi i *Good Practice for Site Visits*. Procesi i vlerësimit përbëhet nga hapat në vazhdim:

1. Zgjedhja dhe takimi me anëtarët e ekipit vlerësues;
2. Përgatitja e Raportit të Vetë-Vlerësimit nga Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani";
3. Vizita në institucion nga EE;
4. Përgatitja e Draft-Raportit nga EE;
5. Përgjigja ndaj Draft-Raportit nga Universiteti i Gjakovës "FehmiAgani";
6. Përgatitja e Raportit Final të Vlerësimit nga EE

Siç u përmend më lartë, para vizitës në institucion, një Raport i detajuar i Vetë-Vlerësimit (RVV) u sigurua nga Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", në të cilin përfshihej një përmbledhje e përgjithshme e deklaratës së misionit, organizimi, menagjimi dhe planifikimi, financat, si dhe informata mbi ndërtesat e universitetit, stafin akademik, programet e studimit, studentët dhe lidhjet ndërkombëtare. Vizita dhe vrojtimi në institucion përfshinë një sër takimesh me anëtarë të ekipit menagjues të universitetit, përgjegjësit për hartimin e programeve të studimit, stafin mësimdhënës dhe studentët, si dhe një vizitë në ndërtesat përkatëse. Ky raport është hartuar duke u bazuar në të gjitha informatat e prezantuara ndaj EE-së gjatë vizitës në institucion dhe materialeve të siguruar vazhdimisht me kërkesë. Ky raport final përfshin gjithashtu reagimet e institucionit ndaj draft-raportit, derguar EE-së pas shqyrtimit të tij.

Përveç dokumenteve me shkrim të siguruar, menagjimenti i Universitetit dha prezantime të detajuara të cilat ishin punuar në mënyrë shumë profesionale. Universiteti i Gjakovës u la përshtypje të fortë ekspertëve si një institucion ku vendimet menagjieriale ndërmirren nga një grup thelbësor i individëve që punojnë në konsultim të afërt me stafin nga fushat akademike dhe administrative të institucionit.

Procesi i Vlerësimit

Në mbrëmjen e 16 prillit 2014, anëtarët e EE u takuan me Z.Basri Muja, Znjsh. Furtuna Mehmeti dhe Prof.Dr. Ferdije Zhushi – Etemi nga AKA për mbledhjen përgatitore dhe darkën e punës. U shpërndanë kopje të printuara

të RVV, dhe u formua komisioni. Prof.Dr. Shezai Rrokaj u pajtua të ishte drejtuesi i ekipit, dhe përgjegjësitë për programet e studimit u ndanë si vijon:

- i. Bachelor në Gjuhë Shqipe (RROKAJ)
- ii. Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (RROKAJ)
- iii. Bachelor në Edukimin Fillor dhe Parashkollor (POL)
- iv. Programe Bachelor Infermieri, Mami dhe Fizioterapi(ŽELEZNIK)
- v. Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze (COLEMAN)

Diskutimi fillestar me menagjmentin e Universitetit, i cili u drejtua nga Prof.Dr. Pol sepse Prof.Dr.Rrokaj mungonte, u mbajt në mëngjesin e 17 prillit 2014. Në mbledhje u diskutuan në çështjet si vijon:

- i. Deklarata e Misionit
- ii. Organizimi dhe Udhëheqja
- iii. Stafi
- iv. Financat
- v. Plani për Zhvillim
- vi. Menagjimi i Cilësisë
- vii. Ndërkombëtarizimi

Pas kësaj mbledhjeje ndërmjet menagjmentit të Universitetit dhe EE, ata vizituan objektet dhe zyrat. Përgjatë drekës, ku EE diskutoi zhvillimin e vizitës në institucion me Z.Muja dhe Prof.Dr.Zhushi-Etemi, anëtarët e EE mbajtën takime me përgjegjësit e stafit për programet e studimit në shqyrtim. Këto takime u pasuan me takime me studentët dhe stafin nga programe të ndryshme të studimit. Gjatë këtyre takimeve anëtarët e EE patën rastin të diskutojnë çështje në lidhje me planprogramin, mësimdhënjen dhe hulumtimin si dhe të njihen me studentët dhe përfaqësues të tjerë të stafit mësimdhënës në Universitet.

Vizita në institucion u mbyll me një takim ndërmjet EE, përfaqësuesëve të AKA-së dhe menagjmentit të Universitetit. U caktuan afatet kohore për dorëzimin e draft-raportit dhe raportit final, si dhe u dorëzua një listë e informatave shtesë të kërkuara nga anëtarët e EE. Këto materiale u siguruan brenda kohës së duhur dhe ky dokument përfaqëson raportin final të vlerësimit nga Ekipi i Ekspertëve për vitin 2014, duke i marrë parasysh të gjitha reagimet e institucionit ndaj draft-raportit.

2. Raporti Institucional

i. Deklarata e Misionit

Ekipi i ekspertëve beson se Deklarata e Misionit është e kënaqshme dhe e pranueshme. Draft raporti propozoi që aspektet e gjuhës duhet të riformulohen. Tani, EE është i kënaqur me formulimin dhe prezantimin e duhur të Deklaratës së Misionit, që qartëson vizionin e saj për standardet e dëshiruara për institucionin.

Idealisht, korniza referuese për një Deklaratë universitare Misioni duhet të pasqyrojë kritere bazike siç janë përmirësimi i proceseve të arsimit dhe mësimdhënjes, krahasueshmëria e gradave dhe çasja e programeve akademike të institucionit brenda kornizës së plotësimit të standardeve evropiane dhe kërkesave të tregut të punës, përfshirjen dhe bashkëpunimin e stafit akademik dhe studentëve në punën shkencore hulumtuese, marrja parasysh e rolit të tyre si vepruesit e vërtetë për arritjen e një mirë-organizimi të institucioneve për arsim të lartë etj. Të gjithë këta faktorë duhet të përfshihen me kujdes në formulimin e Deklaratës Finale të Misionit të institucionit. Universiteti i Gjakovës është pajtuar me të gjitha rekomandimet e bëra në draft-raport. Më tutje, ata u kanë premtuar ekspertëve se një version i rihartuar i Deklaratës së Misionit do të finalizohet në një takim të ardhshëm të bordit.

Rekomandim:

- Të vazhdohet hartimi i Deklaratës së Misionit ashtu që të shprehë qartaz qëllimet e institucionet duke marrë parasysh të gjitha fushat e cekura më lartë.

ii. Organizimi dhe Menagjimenti

Universiteti i Gjakovës është themeluar si pjesë degë e Universitetit të Prishtinës. I pari ka më shumë ngjashmëri se veçanti me të dytin sa i përket organizimit, menagjimentit dhe planifikimit. Themelimi i Universitetit të Gjakovës duhet të shihet si një përpjekje e rëndësishme për zhvillimin e arsimit në Kosovë. Rekomandimi që po japim këtu, atëherë është që Universiteti i Gjakovës të inkurajohet drejtë zhvillimit të një identiteti dhe autonomie në vete.

EE vlerëson iniciativën e institucionit për themelimin e një Qendre të Hulumimit për Integritet Evropian, bashkëpunimin e vazhdueshëm me Universitetin e Prishtinës, si dhe zbatimin e legjislativave përkatëse deri në krijimin e Rregullorës së Brendshme të institucionit.

Tabela e organizimit e përfshirë në RVV pasqyron organogramin e universitetit, në përputhshmëri me Kornizën Evropiane për Programet Arsimore dhe Edukative. Në mënyrë që të arrihet niveli i duhur i Menaxhimit të Institucionit, ne do të rekomandonim që vëmendje prioritare duhet t'i kushtohet Organizimit dhe Planifikimit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet hartimit të një strategjie konkrete për zhvillim në raport me Partnershipet apo bashkëpunimet brenda-institucionale. Rekomandohet hartimi i një dokumenti që parasheh dhe garanton marrëveshje dhe projekte të përbashkëta për konferenca shkencore brenda kornizave të programeve Erasmus, Erasmus Mundus, Erasmus Plus Programmes, Library Projects etj.

Sa i përket organizimit, menaxhimit dhe planifikimit të Universitetit të Gjakovës, rekomandohet punësimi i të paktën dy sekretarëve për secilin fakultet. Si shtesë për dy rekomandimet tona konkrete, theksojmë se edhe pse institucioni do të punësojë 47 profesorë për një numër prej 1300 studentësh, kjo shifër përsëri qëndron larg standardeve evropiane. Sidoqoftë, në dokumentet shtesë sugjerohet që institucioni ka për qëllim të punësojë deri në 95 profesorë në vitet në vazhdim. Ky numër do të përkonte me standardet evropiane. Megjithatë, si hap thelbësor drejtë krijimit të politikave vetë-vlerësuese, në raport me mbajtjen e standardeve, ne rekomandojmë rritjen e këtij numri për shkak të rritjes së mundshme të numrit të studentëve në të ardhmën.

Për më tepër, në Raportin e Vetë-Vlerësimit të institucionit janë paraqitur disa të dhëna në lidhje me infrastrukturën e duhur për aktivitetet akademike të ofruara nga institucioni. Rekomandimet e mësipërme shprehin qartë vëmendjen e veçantë që duhet t'i kushtohet mbajtjes së standardit evropian për 3m² për student, si dhe zbatimin e çasjeve online në shërbimet sekretariale dhe sektorëve tjerë administrativë, në mënyrë që të sigurohet ngritja e cilësisë në proceset edukative dhe arsimuese.

Si përfundim, rekomandohet që Universiteti i Gjakovës të krijojë urgjentisht politika konkrete për të ndihmuar integritetin e stafit akademik, stafin e asistentëve shkencorë akademik si dhe stafin jo akademik. Si përgjigje ndaj draft-raportit, institucioni theksoi se tashmë ka marrë në konsiderim këto çështje dhe premton t'i vlerësojë ato si strategji konkrete zhvillimi mbi të cilat në të ardhmën do të mbështetet performanca e institucionit.

iii. Stafi Akademik

Gjendja e stafit është shumë specifike për shkak të një tranzicioni të institucionit. Sipas përfaqësuesve të Universitetit të Gjakovës të intervistuar

gjatë vizitës në institucion, një pjesë e stafit ishte dhe do të jetë edhe për disa vite tjera nga Universiteti i Prishtinës. Kjo mbështetet në kontratën ndërmjet dy universiteteve, e cila ka për qëllim të mbështesë këtë periudhë të tranzicionit në Universitetin e Gjakovës. Një mbështetje e tillë nga Prishtina do të bëjë ndoshta të mundur që programet të vazhdojnë pa ndërprerje. Grupi i dytë i stafit, potencialisht dhe gradualisht më i rëndësishëm, do të punësohet në bazë të konkurseve publike. Një konkurs i tillë është hapur së fundmi dhe mbetet të shihet çfarë do të dalë nga ai.

Më sa kuptuam ne, stafi ekzistues duket të jetë mjaft i kualifikuar për të drejtuar programet ekzistuese, veçanërisht sa i përket aspekteve të mësimdhënjes. Megjithatë, duhet të theksohet se aktivitetet hulumtuese janë dukshëm të pazhvilluara në rradhë të mësimdhënësve dhe duhet të bëhen përpjekje që kjo mangësi të përmirësohet në të ardhmën.

Sa i përket përpjestimit ndërmjet gjinisë femërore dhe asaj mashkullore ndër stafin akademik, përsëri kjo do të varet nga rezultatet e politikës së institucionit. Nuk u duk ende ndonjë politikë që kishte për qëllim arritjen e një bilanci në këtë aspekt.

Në u siguroam nga UGJ se rregulla transparente, konkurrese dhe të drejtuara nga cilësia duhet të zhvillohen në muajt në vazhdim dhe më vonë. E njejta vlen për strategjitë zhvilluese të institucionit të cilat do kenë për qëllim të sigurojnë se stafi akademik do vazhdojë të mbajë një standard të lartë.

Rekomandime:

- Të përmirësohet aspekti hulumtues i punës së tërë stafit akademik;
- Të sqarohet politika e Universitetit në lidhje me barazinë gjinore;
- Të sqarohen kornizat institucionale për zhvillimin e standardeve cilësore në hulumtim.

iv. Financat

Universiteti i Gjakovës mbështetet financiarisht nga shteti – kjo duket të jetë burimi kryesor i të ardhurave të këtij institucioni. Përfaqësuesit e Universitetit gjithashtu theksuan se komuna e Gjakovës synon të përfshihet duke mbështetur deri në një masë infrastrukturën e universitetit (u përmend një ndihmë për ndërtesat e ngjashme me kampus të universitetit). Ekziston një plan financiar për këtë periudhë tranzicioni dhe një plan i ri do të hartohet për periudhën pas tetorit 2014. Sistemi i qarkullimit të të ardhurave është momentalisht duke u zhvilluar dhe duke u zbatuar gradualisht.

Institucioni ka në dispozicion tri ndërtesa për aktivitete mësimore; një nga ato është momentalisht në renovim dhe do të jetë e disponueshme për mësim nga vjeshta 2014.

Disa pjesë të infrastrukturës të cilat duhet të mbështesin mësimin janë në gjendje kritike – kjo vlen veçanërisht për bibliotekën, e cila është shumë larg minimumit të standardeve. Përfaqësues të universitetit theksuan se biblioteka e qytetit të Gjakovës është momentalisht duke iu shërbyer studentëve si burim. Ne nuk e kontrolloam më shumë këtë pikë. Gjatë diskutimit me studentët mësuam se ata nuk ankohen për disponueshmërinë e burimeve të mësimi.

Rekomandime:

- Të kompletohet plani për qarkullimin e të ardhurave dhe të konsiderohet investim i mëtutjeshëm për infrastrukturën për hulumtim;
- Të investohet për një bibliotekë më të mirë universitare si një çështje esenciale për fazën zhvillimore të universitetit;
- Të kërkohen fonde dhe sponzorime të jashtme për infrastrukturë të duhur për hulumtim dhe mësim.

v. Plani Zhvillimor

Edhe pse Universiteti i Gjakovës nuk parasheh themelimin e qendrave të reja të hulumtimit në të ardhmën e afërt, Universiteti ka një prirje të fortë për zhvillim institucional. Plani zhvillimor i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" është hartuar në bazë të parimeve zhvillimore të universitetit, duke pasur në mendje se disa nga programet kanë filluar qysh nga tetori 2013 të përmbushin nevojat kryesore për zhvillim të programeve, duke përfshirë edhe ato të rejat. Për momentin, është vështirë të parashikohen shifrat e punësimit në universitet për periudhën 2014-2015, pasi që konkurset për punësim janë ende në proces e sipër. Sidoqoftë, është e ditur se nevojat e stafit për periudhën 2014-2015 do të përmbushen nga një Memorandum Marrëveshjeje me Universitetin e Prishtinës dhe nga stafi që është momentalisht i punësuar në universitet.

Universiteti filloi veprimtarinë e tij në vitin e parë akademik 2013/2014 me tre departamente: Departamenti i Edukimit, Departamenti i Mjekësisë dhe Departamenti i Filologjisë. Komisioni udhëheqës i universitetit ka vendosur të themelojë dy departamente të reja – një Departament të Shkencave Sociale dhe një Departament të Shkencave të Aplikuara.

Ekzistojnë plane për ofrimin e trajnimeve për metoda të mësimdhënjes për të gjithë mësimdhënësit momentalë dhe ata të rinjë në Universitet. Mëtutje, për të motivuar stafin akademik që të marrë pjesë nëpër konferenca, universiteti do të mbulojë të gjitha kostot e pjesëmarrjes. Për stafin akademik të cilët janë momentalisht të angazhuar në studime doktrale, universiteti është duke ofruar orare fleksibile të punës si dhe rregullime financiare.

Për momentin, një numër i stafit administrative është i angazhuar në Universitetin e Prishtinës, duke përfshirë stafin akademik në programet e Departamentit të Edukimit (2 të punësuar), stafi për çështje akademike në programet e Departamentit të Filiologjisë (2 të punësuar); një coordinator për njohuri praktike (1 i punësuar), një bibliotekis (1 i punësuar), një arkivist (1 i punësuar) dhe një kopështar (1 i punësuar). Komisioni drejtues i Universitetit të Gjakovës gjithashtu ka aprovuar Rregullorën për pagesat e stafit sipas renditjes vijuese:

- Drejtori
- Zyrtari për çështje akademike
- Udhëheqësit e shërbimeve (Administrata qendrore)
- Menagjerët (Administrata qendrore)
- Zyrtarët e auditimit
- Zyrtarët e certifikimit
- Zyrtarët për mbikqyrjen e ndërtimeve në UGJ
- Zyrtari për Buxhetin dhe Financat
- Zyrtari për çështje ligjore
- Zyrtari për pagesat
- Per-diems and payments officer
- Zyrtari për shërbime (Administrata qendrore)
- Asistenti i Komisionit drejtues
- Teknikët administrativë dhe IT
- Arkatari
- Redaktori i shtëpisë botuese
- Asistenti i zyrës së Rektorit
- Shoferi i zyrës së Rektorit
- Currier at the rector's premises
- Barmeni i kafeterisë
- Zyrtari i lartë për studime master dhe doktoraturë
- Zyrtari i lartë për studime bachelor
- Zyrtari i lartë për kontabilitet dhe financa në departament
- Koordinator i ligjeratave në departament
- Koordinator për Park
- Zyrtari për ligjeratat në departament
- Zyrtari për shërbimet për studentë
- Zyrtarët logjistikë, pronat
- Zyrtari për arkivat, postën dhe fotokopjet
- Laboranti
- Bibliotekisti
- Asistenti i dekanit
- Zyrtari për analiza

Sa i përket infrastrukturës, gjatë viteve 2013-2015 Universiteti i Gjakovës planifikon të zgjerojë ndertesat në vijim:

- Ndërtesa e Rektoratit, 2135 m²

- Ndërtesa e Shkollës Teknike "Nexhmedin Nixha", 7117 m²
- Ndërtesa e Shkollës Filllore "Nimon Ferizi", 1740 m²

Universitetit të Gjakovës i është caktuar një hapësirë prej 132,095 m² nga Komuna e Gjakovës për ndërtimin e kampusit universitar.

Në përgjigjen ndaj draft-raportit, Universiteti i Gjakovës konfirmoi përkushtimin e tij ndaj këtyre planeve dhe theksoi se në qërshor 2014 universiteti do të vazhdojë me punësimin e stafit të ri administrativ dhe akademik. Më tutje, është deklaruar se €160,000 do të ndahen për renovimin e ndërtesave ekzistuese, ndërsa €500,000 do të dedikohen për vitin 2015. Korniza për zgjerim afatmesëm e universitetit do të ndajë €2 milion të tjera për vitin 2016, shifër e njejtë më atë të dedikuar edhe për vitin 2017 për zhvillimin e kampusit kryesor të universitetit. Planët për tërheqjen e punëdhënësve lokalë ndaj institutit përfshijnë mundësitë për bursa për programe magjistrature dhe doktorature, si dhe mundësi për arsimim për secilën moshë.

Rekomandime:

- T
ë vazhdohet punësimi i stafit akademik dhe administrative si çështje urgjente, siç është theksuar edhe në përgjigjen ndaj draft-raportit.
- T
ë vazhdohet me planin për zhvillimin dhe zgjerimin e infrastrukturës, veçanërisht në lidhje me kampusin kryesor të universitetit, siç është theksuar edhe në përgjigjen ndaj draft-raportit.
- T
ë tentohet tërheqja e punëdhënësve të cilët veprojnë në Gjakovë dhe të përqendrohet energjia e tyre në këtë qytet dhe regjion, siç është theksuar edhe në përgjigjen ndaj draft-raportit.

vi. Menagjimi i Cilësisë

Sipas Raportit të Vetë-Vlerësimit, Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" ka themeluar një Zyre për Zhvillim Akademik dhe Menagjim të Cilësisë me qëllim që të sigurojnë cilësi, barazi, transparencë dhe efikasitet. Universiteti është gjithashtu i përkushtuar ndaj performacave të nivelit të lartë në secilin department dhe program dhe sheh përmirësimin e cilësisë si një përgjegjësi individuale dhe kolektive. Universiteti është duke zhvilluar një kulturë për cilësi duke i kushtuar vëmendje të veçantë menagjimit dhe sigurimit të cilësisë. Qëllimi thelbësor i menagjimit të cilësisë është zhvillimi efektiv dhe monitorimi i politikave dhe procedurave.

Që të arrihet kjo, Universiteti përqëndron dhe përfshin komponentët e cilësisë në planin e tij strategjik dhe politikat për sigurim të cilësisë me aktivitete dhe role qartazi të detajuara, të dyja duke qenë bazat për funksionimin e strukturës së cilësisë. Vlerësimi dhe matja e arritjeve dhe zbatimi i prioriteteve kyçe për ngirtjen e cilësisë realizohet nëpërmjet planeve

të veprimit të departamenteve dhe programeve, të cilat janë aprovuar dhe monitoruar nga udhëheqësia e lartë. Universiteti ka gjithashtu për qëllim të rrisë numrin e institucioneve dhe revistave hulumtuese. Zyra për Hulumtim dhe zv.rektori për mësimdhënje mbështesin këto aktivitete të rëndësishme. Universiteti ka gjithashtu për qëllim të mbështesë performancën efektive të personelit akademik.

Për personelin akademik kjo arrihet nëpërmjet procedurave vjetore siç janë: vrojtimi i mësimit dhe nxënjes duke marrë parasysh mendimin/vlerësimin e studentëve nëpërmjet mjeteve të ndryshme siç janë pyetësorët dhe intervistat. I gjithë stafi është i obliguar të marrë pjesë në procesin e vlerësimit dhe tërë procesi është pjesë integrale e procesit për zhvillim të personelit.

Proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë mbikqyrën nga Komisioni Drejtues i Universitetit, i cili aprovon planin strategjik dhe mban përgjegjësi për sigurimin e cilësisë. Rektori i universitetit udhëheq procesin e sigurimit të cilësisë dhe është përgjegjës i Komisionit Drejtues. Një Këshilltar ekzekutiv (apo njëri nga zv.rektorët, zv.rektori për mësim) për cilësi dhe performancë – mbikqyrë dhe jep këshilla për procedurat kyçe në lidhje me cilësinë, performancën dhe iniciativat të cilat mbështesin në përgjithësi kultivimin e cilësisë. Një Zyrtar për Sigurimin e Cilësisë punon për së afërmi me Këshilltarin Ekzekutiv për të koordinuar aktivitetet për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Cilësisë dhe Komisioni Menagjerial përbëhen nga rektori, zv.rektorët, sekretari permanent dhe këshilltari ekzekutiv. Komisioni zhvillon dhe monitoron proceset për sigurimin e cilësisë dhe raporton te Senati dhe Komiteti Drejtues i universitetit.

Secili department në universitet ka gjithashtu një ekip për sigurim të cilësisë i cili përbëhet nga dekani, zv.dekanët, përfaqësuesë të personelit akademik, një përfaqësues nga grupi i studentëve, një anëtar i jashtëm (aksionar) profile i të cilit përkon me fushën e departamentit dhe asistenti administrativ i departamentit.

Struktura të mira janë vendosur për të siguruar performancë cilësore në mësimdhënje. Performanca e profesorëve/ligjëruesëve në një lëndë matet nëpërmjet treguesëve të ndryshëm. Kjo fillon me hartimin e planprogramit të lëndës dhe prezencës së mësimdhënësve në ligjerata, e cila dokumentohet nëpërmjet 15 studentëve që figurojnë gjithashtu në listën e prezencës. Si shtesë ndër detajet e kursit, lista e prezencës përmban gjithashtu temën e javës e cila duhet të përkojë me planprogramin. Në fund të semestrit, ligjëruesi është i obliguar të sigurojë dokumentet dhe dëshmitë në notimin e secilit student bazuar në formularë të përveçëm në Zyrën për Zhvillim Akademik. Gjithashtu, në fund të semestrit mbahet një provim final dhe pasha e tij në përqindje në notën përfundimtare caktohet nga Rregullorja për studime në nivelin përkatës të edukimit. Kjo përcakton shkallën e suksesit të studentëve në lëndën përkatëse. Studentët vlerësojnë gjithashtu mësimdhënësit nëpërmjet pyetësorëve anonimë pas javës së shtatë të mësimit dhe pas përfundimit të tij.

Zyra për Zhvillim Akademik dhe Menagjim të Cilësisë në Universitetin e Gjakovës ka hartuar një plan vrojtimi me një sër objektivash të qarta: p.sh të mbështesë qëllimin strategjik të universitetit në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimin dhe nxënjes; të mbledhë dëshmi të sigurimit të cilësisë në nivel universitar dhe të departamenteve; të sigurojë një cilësi të lartë të përvojës së të nxënimit për studentët në secilin departament; të vërtetojë praktikën shembullore dhe të lehtësojë shpërndarjen e tyre në të gjitha departamentet dhe në tërë universitetin; të mbështesë zhvillimin profesional të secilit prej anëtarëve të stafit; të sigurojë se mësimi dhe nxënja janë të pandashme nga përkushtimi i universitetit për barazi; të mbledhë informata mbi proceset tjera përkatëse, veçanërisht në procesin vjetor të vetë-vlerësimit dhe ofrimin e bonuseve për personelin. Secili anëtar i personelit vrojtohet nga vrojtues të trajnuar nga departamenti përkatës apo ekipi qëndror i universitetit. Anëtarëve të personelit mësimdhënës u ofrohen këshilla para ligjeratave dhe gjithashtu një feedback në formë raporti. Një raport përmblidhës iu shpërndahet të gjithë personelit akademik dhe studentëve dy herë mbrenda vitit. Gjithashtu raportet specifike për departamentet dhe mundësitë relevante për trajnime grumbullohen dhe shpërndahen.

Në Universitetin e Gjakovës studentëve u kërkohet të plotësojnë një pyetësor dy herë në vit për vlerësimin e personelit akademik, lëndët që ata ndjekin dhe edikacionin e shërbimeve administrative.

Rezultatet e këtyre pyetësorëve i shpërndahen secilit nga stafi akademik dhe departamenti administrative dhe përmblidhet janë të disponueshme për analiza dhe përdorim për departamentet/qendrat në nivel universitar. Rezultatet individuale shërbejnë si pjesë e procesit të vlerësimit personal. Rezultatet gjithashtu prezantohen në takimin e Senatit dhe Komisionit Drejtues si dhe përfshihen në planet për veprim të departamenteve. Ekziston gjithashtu një procedurë ankuese për studentët, e cila mund të përdoret në rast të ngritjes së ndonjë çështjeje.

Secili departament i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" ka gjithashtu një zyrë për zhvillim akademik e cila udhëhiqet nga koordinatore. Përveç përgjegjësisë së tyre me ESC, ata janë gjithashtu përgjegjës për ofrimin e këshillave në lidhje me ECTS për ligjëruesit. Koordinatorët janë gjithashtu përgjegjës për menagjimin e orareve të studentëve në pajtim me planprogramin e hartuar nga ligjëruesit. Ata gjithashtu ndihmojnë studentët për transferimin e kredive ECTS prej dhe/ose në një tjetër departament/universitet.

Rekomandime:

- Universiteti i Gjakovës ka vendosur një sistem shumë të qartë dhe mbreslënës të Menagjimit të Cilësisë, siç është përshkruar këtu duke u bazuar në RVV. Përderisa numri i stafit dhe studentëve do rritet, është e detyrueshme që këto standarde të mbahen në secilin aspekt. Një zyre dhe zyrtar për cilësi mund ta parashikojë këtë proces.

- Gjersa korniza të qarta janë vendosur për të siguruar cilësi në mësimdhënje, më shumë duhet të bëhet për të treguar dhe mbajtur cilësi në hulumtim. Kjo duhet të theksohet dhe të zhvillohet në planin e ardhshëm strategjik të universitetit, dhe nevojiten më shumë dëshmi për të treguar se Universiteti i Gjakovës është një qendër e përsosshmërisë në fushat përkatëse të hulumtimit të departamenteve ekzistuese.

vii. Ndërkombëtarizimi

Universiteti i Gjakovës ka bashkëpunim të afërt me Universitetin e Shkencave të Aplikuara Muenster (MUAS). Instituti i Evropës Lindore për Zhvillim të Shkencave Mjekësore dhe Infermieri (SEE) përmban një qendër për edukim profesional "QEAP-Heimerer". Universiteti ka gjithashtu bashkëpunim me Universitetin e Mariborit, Slloveni dhe Universitetin e Shkencave Mjekësore Hall/Tyrol (UMIT).

Universiteti i Gjakovës do të përfshihet në programin e studimit Tempus: "Interdisciplinary reformation structure and innovative professions for Higher Education" (Project: Number 530752-TEMPUS-2012-JPCR). Universiteti do të nënshkruanjë një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Shtetëror të Tiranës, Universitetin Mjekësor të Tiranës, Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali", Universitetin e Tetovës, Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka" dhe Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti".

Në të ardhmën e afërt Universiteti i Gjakovës do të nënshkruajë gjithashtu një memorandum të bashkëpunimit me fakultetet e motëruara brenda Universitetit të Sllovenisë dhe Universitetit të Zagrebit në Kroaci. Memorandumet ekzistuese të bashkëpunimit me universitetet në rajon duhet të zhvillohen ashtu që këto bashkëpunime të jenë shumë më të dobishme.

Rekomandime:

- Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Gjakovës duhet të kërkojë bashkëpunime të mëtutjeshme institucionale në nivel të shkollimit të studentëve dhe stafit. Kjo do të forconte më tej ndërtimin e një shkollimi konkurrues mjekësor në universitet.
- Universiteti këshillohet që të fillojë më shumë programe shkëmbimi ndërkombëtar sa më shpejtë që të jetë e mundur.

3. Raportime në Programet e Studimit

i. Bachelor në Gjuhë Shqipe

* Raporti final në programin Bachelor në Gjuhë Shqipe është hartuar si document i veçantë në gjuhën shqipe nga Prof. Dr. Shezai Rrokaj.

ii. Bachelor në Letërsi Shqipe

* Raporti final në programin Bachelor në Gjuhë Shqipe është hartuar si document i veçantë në gjuhën shqipe nga Prof. Dr. Shezai Rrokaj.

iii. Bachelor në Edukim Parashkollor

Prof.Dr. Milan Pol (Masaryk University, Czech Republic)

Programi bachelor në Edukim Parashkollor është mbajtur në Gjakovë si degë e Universitetit të Prishtinës (UP deri në vitin 2013; ndërsa tani ai mbahet si i pavarur në kuadër të UGJ, në bashkëpunim të përkohshëm më UP, (sipas marrëveshjes). Duket se karakteristikat kryesore të programit mbesin shumë të ngjashme me programet e mbajtura deri në 2013 – në fakt, ky është një lloj vazhdimi, sa i përket planprogramit, idesë kryesore të tij dhe konceptit të realizimit.

Programi Akademik dhe Menagjimi i Studentëve

Sa i përket Programit Akademik dhe Menagjimit të Studentëve, ky program duket që përkon me deklaratën e misionit, siç është përshkruar në aplikacion. Programi mund të shifet deri dikund si në vijë me parimet e veprimit.

Cilësia, shtrirja dhe qëllimet akademike janë formuluar në një mënyrë të pranueshme duke marrë parasysh rrethanat. Koncepti i programit në thelb është logjik, unë e shoh si përkatës dhe në një mënyrë i krahasueshëm me programet e ngjashme në tjera vende (përfaqësuesit e UGJ deklaruan se koncepti kryesor i programit është i ngjashëm me atë të programeve të tilla në Universitetin e Lubljanës dhe Universitetin e Zagrebit, dhe unë mund ta pranoj këtë).

Ka shumë lëndë studimi në planprogram dhe shumë orë mësimi të cilat studentët duhet t'i shpenzojnë në premisat universitare. Lëndët duket që mbulojnë fushat kryesore të edukimit parashkollor dhe për mua janë përkatëse, në parim. Do të doja të shihja një mënyrë sit ë integrohen njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në këto lëndë – por mënyrat për të matur këtë nuk janë sqaruar në planprogram.

Lëndët janë të ndara në dy grupe: obligative dhe zgjedhore. Numri i lëndëve dhe orëve të mësimi është paksa i lartë dhe shtrohet pyetja nëse një ngarkesë e tillë iu lë vend të mjaftueshëm studentëve për mësim të pavarur. Në anën tjetër, ndoshta duhet të mirret parasysh fakti që disa nga burimet për të mbështetur mësimin individual të studentëve janë ende vështirë të disponueshme (burimet bibliotekore – librat, revistat, të dhënat etj). Duke shiquar këtë, një orar më i gjatë i mësimi (orëve të kontaktit) mund të shihet

si një strategji e mirë për të kompenzuar mungesën e burimeve të tjera të mësimit. Sidoqoftë, kjo më duket e pranueshme vetëm për një periudhë të shkurtë kohore. Gjithashtu, sistemi informues për të mbështetur organizimin e programit ende mungon; disa mësime janë duke ofruar informata nëpërmjet ëeb-faqeve të tyre personale, mirëpo ato nuk kanë lidhje me ëeb-faqën e UGJ.

Programi është hartuar në formë të një programi me orar të plotë. Metodatat e mësimeve duken të pranueshme dhe të kuptueshme për rrethanat ekzistuese; siç duket, ka një përzierje e grupeve të vogla dhe grupeve më të mëdha gjatë procesit mësues (ligjerata/seminare). Një nga pikat e forta të programit është që studentët shkojnë në institute parashkollore nëpër tërë regjionin. Sasia e praktikës është e kënaqshme, gjithashtu dhe sistemi i organizimit të praktikës (gjatë procesit të praktikës përfshihet një mbyqyrës nga fakulteti, një mentor nga instituti parashkollor). Shpërndarja e ECTS është e pranueshme. Është e mundur që në disa pjesë të planprogramit disa përmbajtje akademike deri në një masë mbulojnë njëra-tjetrën.

Kriteret e pranimit janë të qarta dhe përkatëse. Provimi i fundit përfshin vetëm mbrojtjen e temës së diplomës (kriteret më specifike sa i përket temës së diplomës do të ishin të mirëseardhura). Nuk ekziston ndonjë provim që të shkojë bashkë me temën e diplomës – kjo është ajo që rekomandoj të rishiqohet dhe mundësisht të ndryshohet.

Përpjestimi mësues/student duket të jetë i pranueshëm.

Stafi

Sa i përket stafit, gjendja është shumë specifike, siç është theksuar tashmë në pjesën e raportit në lidhje me UGJ si institucion. Programi mbështetet pjesërisht në anëtarë të stafit që vijnë nga UP dhe pjesërisht nga ata që pritet të punësohen muajve në vazhdim. Stafi momental duket të ketë kualifikime përkatëse për të dhënë mësim në nivel bachelor, mirëpo aktiviteti i hulumtimit dhe i publikimit është ende shumë i ulët. Kjo është një nga mangësitë e stafit dhe duhet gjithsesi të përmirësohet në të ardhmën. Duhet të theksohet se një ndryshim i tillë i qëndrimit ndaj hulumtimit është ndoshta çështje e matjeve të ndryshme që po zhvillohen dhe po zbatohen në nivele të ndryshme të sistemit të arsimit në Kosovë, duke filluar nga qendra e deri tek fakulteti (ose departamentet) Mos-ekzistenca e një buxheti të dedikuar për hulumtim është ndoshta një nga problemet.

Hulumtimi dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Siç veçse është theksuar më lartë, hulumtimi paraqet një aspekt shumë të dobët të programit. Sidoqoftë, një hulumtim në masë të vogël bëhet gjatë qëndrimeve praktike të studentëve në institucionet parashkollore, siç deklaruan disa nga stafi i UGJ. Ky hulumtim u shërben studentëve si bazë për temën e diplomës të cilët mbikqyrën nga stafi (u theksua një limit prej 10 studentëve të mbikqyrur nga një anëtar i stafit).

UGJ duket se ka një shkallë të caktuar të dimensionit ndërkombëtar (ose ndër-regjional) – përveç studentëve nga Kosova ka edhe studentë nga vendet fqinje, Shqipëria dhe Mali i Zi. Shumë më shumë aktivitete ndërkombëtare në të gjitha aspektet e programit do të ishin shumë të dëshirueshme (p.sh shkëmbimet brenda programit Erasmus).

Financat dhe Infrastructura

Siç është theksuar tashmë në pjesën e raportit kushtuar UGJ si institucion, ekziston një plan buxhetor për periudhën e tanishme dhe një plan i ri i përqendruar në parim të qarkullimit të të ardhurave do të zhvillohet deri në tetor 2014. Ky plan duhet të shërbejë gjithashtu si bazë për veprimin e programit përkatës.

Duket se UGJ ka ndërtesa të mjaftueshme për aktivitetet mësimore sa i përket programit, edhe pse pajisjet mbështetëse të mësimit kanë nevojë për përmirësim. Ndoshta një ndihmë komunale siç u përmend nga UGJ do të kishte rol pozitiv në lidhje me këtë.

Menagjimi i Cilësisë

Siç duket, menagjimi i cilësisë po vjen në shprehje gradualisht. Sipas përfaqësuesve të UGH, Zyra e re për Cilësi do të themelohet së shpejti dhe do të ketë për detyrë të sigurojë cilësi në të gjitha aspektet kryesore të veprimit të UGJ. Megjithatë, proceset e vlerësimit të brendshëm duket të jenë në hapat e tyre fillestarë.

Rekomandim

Mund të shoh potencialin e programit, por gjithashtu edhe disa mangësi, siç u theksua më lartë. Rekomandimi im i përgjithshëm është që t'i jipet akreditimi programit të Edukimit Parashkollor (grada bachelor) për një periudhë të caktuar gjatë të cilës të kërkohet nga UGH të hartojë dhe dorëzojë një plan shumë konkret dhe realist për të eliminuar këto mangësi dhe për të përballuar sfidat e institucionit të rid he të pavarur në qendrën regjionale të Gjakovës.

iv. Bachelor në Edukim Fillor

Prof.Dr. Milan Pol (Masaryk University, Czech Republic)

Programi bachelor në Edukim Fillor është mbajtur në Gjakovë si degë e Universitetit të Prishtinës (UP deri në vitin 2013; ndërsa tani ai mbahet si i

pavarur në kuadër të UGJ, në bashkëpunim të përkohshëm me UP, (sipas marrëveshjes). Duket se karakteristikat kryesore të programit mbesin shumë të ngjashme me programet e mbajtura deri në 2013 – në fakt, ky është një lloj vazhdimi, sa i përket planprogramit, idesë kryesore të tij dhe konceptit të realizimit.

Programi Akademik dhe Menagjimi i Studentëve

Sa i përket Programit Akademik dhe Menagjimit të Studentëve, ky program duket që përkon me deklaratën e misionit, siç është përshkruar në aplikacion. Programi mund të shifet deri dikund si në vijë me parimet e veprimtimit.

Cilësia, shtrirja dhe qëllimet akademike janë formuluar në një mënyrë të pranueshme duke marrë parasysh rrethanat. Koncepti i programit në thelb është logjik, unë e shoh si përkatës dhe në një mënyrë të krahasueshme me programet e ngjashme në tjera vende (përfaqësuesit e UGJ deklaruan se koncepti kryesor i programit është i ngjashëm me atë të programeve të tilla në Universitetin e Lubljanës dhe Universitetin e Zagrebit, dhe unë mund ta pranoj këtë).

Ka shumë lëndë studimi në planprogram dhe shumë orë mësimi të cilat studentët duhet t'i shpenzojnë në premisat universitare. Lëndët duket që mbulojnë fushat kryesore të edukimit parashkollor dhe për mua janë përkatëse, në parim. Do të doja të shihja një mënyrë sit ë integrohen njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në këto lëndë – por mënyrat për të matur këtë nuk janë sqaruar në planprogram.

Lëndët janë të ndara në dy grupe: obligative dhe zgjedhore. Numri i lëndëve dhe orëve të mësimi është paksa i lartë dhe shtrohet pyetja nëse një ngarkesë e tillë iu lë vend të mjaftueshëm studentëve për mësim të pavarur. Në anën tjetër, ndoshta duhet të mirret parasysh fakti që disa nga burimet për të mbështetur mësimin individual të studentëve janë ende vështirë të disponueshme (burimet bibliotekore – librat, revistat, të dhënat etj). Duke shiquar këtë, një orar më i gjatë i mësimi (orëve të kontaktit) mund të shihet si një strategji e mirë për të kompenzuar mungesën e burimeve të tjera të mësimi. Sidoqoftë, kjo më duket e pranueshme vetëm për një periudhë të shkurtë kohore. Gjithashtu, sistemi informues për të mbështetur organizimin e programit ende mungon; disa mësimdhënës janë duke ofruar informata nëpërmjet ëeb-faqeve të tyre personale, mirëpo ato nuk kanë lidhje me ëeb-faqën e UGJ.

Programi është hartuar në formë të një programi me orar të plotë. Metodatat e mësimdhënës duken të pranueshme dhe të kuptueshme për rrethanat ekzistuese; siç duket, ka një përzierje e grupeve të vogla dhe grupeve më të mëdha gjatë procesit mësimor (ligjerata/seminare). Një nga pikat e forta të programit është që studentët shkojnë në institute parashkollore nëpër tërë regjionin. Sasia e praktikës është e kënaqshme, gjithashtu dhe sistemi i organizimit të praktikës (gjatë procesit të praktikës përfshihet një mbykqyrës

nga fakultetit, një mentor nga instituti parashkollor). Shpërndarja e ECTS është e pranueshme. Është e mundur që në disa pjesë të planprogramit disa përmbajtje akademike deri në një masë mbulojnë njëra-tjetrën.

Kriteret e pranimit janë të qarta dhe përkatëse. Provimi i fundit përfshin vetëm mbrojtjen e temës së diplomës (kriteret më specifike sa i përket temës së diplomës do të ishin të mirëseardhura). Nuk ekziston ndonjë provim që të shkojë bashkë me temën e diplomës – kjo është ajo që rekomandoj të rishiqohet dhe mundësisht të ndryshohet.

Përpjestimi mësimdhënës/student duket të jetë i pranueshëm.

Stafi

Sa i përket stafit, gjendja është shumë specifike, siç është theksuar tashmë në pjesën e raportit në lidhje me UGJ si institucion. Programi mbështetet pjesërisht në anëtarë të stafit që vijnë nga UP dhe pjesërisht nga ata që pritet të punësohen muajve në vazhdim. Stafi momental duket të ketë kualifikime përkatëse për të dhënë mësim në nivel bachelor, mirëpo aktiviteti i hulumtimit dhe i publikimit është ende shumë i ulët. Kjo është një nga mangësitë e stafit dhe duhet gjithsesi të përmirësohet në të ardhmën. Duhet të theksohet se një ndryshim i tillë i qëndrimit ndaj hulumtimit është ndoshta çështje e matjeve të ndryshme që po zhvillohen dhe po zbatohen në nivele të ndryshme të sistemit të arsimit në Kosovë, duke filluar nga qendra e deri tek fakulteti (ose departamentet) Mos-ekzistenca e një buxheti të dedikuar për hulumtim është ndoshta një nga problemet.

Hulumtimi dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Siç veçse është theksuar më lartë, hulumtimi paraqet një aspekt shumë të dobët të programit. Sidoqoftë, një hulumtim në masë të vogël bëhet gjatë qëndrimeve praktike të studentëve në institucionet parashkollore, siç deklaruan disa nga stafi i UGJ. Ky hulumtim u shërben studentëve si bazë për temën e diplomës të cilët mbikqyrën nga stafi (u theksua një limit prej 10 studentëve të mbikqyruar nga një anëtar i stafit).

UGJ duket se ka një shkallë të caktuar të dimensionit ndërkombëtar (ose ndër-regjional) – përveç studentëve nga Kosova ka edhe studentë nga vendet fqinje, Shqipëria dhe Mali i Zi. Shumë më shumë aktivitete ndërkombëtare në të gjitha aspektet e programit do të ishin shumë të dëshirueshme (p.sh shkëmbimet brenda programit Erasmus).

Financat dhe Infrastruktura

Siç është theksuar tashmë në pjesën e raportit kushtuar UGJ si institucion, ekziston një plan buxhetor për periudhën e tanishme dhe një plan i ri i përqendruar në parim të qarkullimit të të ardhurave do të zhvillohet deri në tetor 2014. Ky plan duhet të shërbejë gjithashtu si bazë për veprimin e programit përkatës.

Duket se UGJ ka ndërtesa të mjaftueshme për aktivitetet mësimore sa i përket programit, edhe pse pajisjet mbështetëse të mësimit kanë nevojë për përmirësim. Ndoshta një ndihmë komunale siç u përmend nga UGJ do të kishte rol pozitiv në lidhje me këtë.

Menagjimi i Cilësisë

Siç duket, menagjimi i cilësisë po vjen në shprehje gradualisht. Sipas përfaqësuesve të UGH, Zyra e re për Cilësi do të themelohet së shpejti dhe do të ketë për detyrë të sigurojë cilësi në të gjitha aspektet kryesore të veprimit të UGJ. Megjithatë, proceset e vlerësimit të brendshëm duket të jenë në hapat e tyre fillestarë.

Rekomandim

Mund të shoh potencialin e programit, por gjithashtu edhe disa mangësi, siç u theksua më lartë. Rekomandimi im i përgjithshëm është që t'i jipet akreditimi programit të Edukimit Parashkollor (grada bachelor) për një periudhë të caktuar gjatë të cilës të kërkohet nga UGH të hartojë dhe dorëzojë një plan shumë konkret dhe realist për të eliminuar këto mangësi dhe për të përballuar sfidat e institucionit të rid he të pavarur në qendrën regjionale të Gjakovës.

v. Bachelor program in Nursing

Prof.Dr.Danica Železnik (Univ. College of Health Sciences Slov. Gradec, Slovenia)

Programet Akademike dhe Menagjimi i Studentëve

Programi akademik përkon me deklaratën e misionit të institucionit dhe parimet e veprimit. Universiteti i Gjakovës ka bashkëpunim të afërt me Universitetin e Prishtinës.

UGJFA është duke ofruar një program të studimit të arsimit të lartë në Infermieri, i cili është në pajtim me direktivën e BE-së (2005/36/EC), marrëveshjen e Bolonjës, dhe u mundëson punësim të diplomuarve në të gjitha vendet e BE-së.

Niveli i parë i programit të studimit të Infermierisë paraqet një program në të cilin ofrohet një profil bazik i infermierisë. Ky është hartuar në pajtim me nevojat e shoqërisë moderne, dhe kombinon praktiën dhe teorinë. Ai u ofron studentëve mundësinë për të zgjedhur kurset në vitin e parë, dytë dhe tretë të studimit. Gjithashtu ofron edhe njohuri teorike dhe praktike.

Program i Infërmierisë është i ndarë në 6 semestra dhe zgjat tre vite akademike, baraz ECTS. Secili semestër vlen 30 kredi. Niveli i kualifikimit sipas NQF është Bachelor. Studimet përfshijnë bazat e: shkencave

biomjekësore, shkencave humane dhe njerëzore dhe shkenca e infermierisë profesionale klinike.

Trajnimet klinike zënë vend direkt në ambientet klinike nën udhëheqjen e mentorëve të institucionit arsimor. Koordinatorë të universitetit janë gjithashtu të përfshirë në trajnimin klinik (mësimdhënës/asistentë). Institucionet arsimore ku bëjnë pjesë trajnimet klinike janë në pajtim me kriteret e Ministrisë së Shëndetësisë në Kosovë. Trajnimi klinik është një pjesë e rëndësishme për formimin e kompetencave profesionale. Universiteti i Gjakovës duhet të vrojtojë kujdesshëm procesin e mbikqyrjes dhe ta vlerësojë atë rregullisht.

Planprogrami përmban gjithsej 5.400 orë mësimi, nga të cilat 2.105 në amfiteatër (ligjerata, seminare, ushtrime laboratorike) nga 45 minuta, 2.425 orë praktike në kujdesin shëndetësor (ambulancë, spital, klinikë) dhe 807 orë mësim i pavarur.

Titulli i plotë i gradës akademike: Bachelor në Infermieri të Përgjithshme. Numri i vendeve: 50, forma e studimit: e rregullt.

Dokumentet e siguruar deri dikund e përkufizojnë shtrirjen akademike por nevojitet përpunim i mëtutjeshëm që ato të përkojnë me standardet e BE-së. Eksperti nga lënda përkatëse u takua me stafin mësimdhënës, të cilët vinin shumica nga profesionet mjekësore. Infermiera është disiplinë tjetër nga mjekësia dhe i duhet një çasje tjetër, por mbetet mbështetje për mësimet mjekësore të cilat duhet të adresohen. Kjo është qartësisht e definuar në standardet e BE-së. Ekzistojnë udhëzime të qarta në direktivën e BE-së të cilat përkufizojnë pritshmëritë për marrjen e diplomës bachelor në Infermieri. Sipas tyre, mësimi duhet të ndahet në mënyrë të barabartë ndërmjet teorisë dhe praktikës nën mbikqyrjen e një infermieri të kualifikuar.

Stafi

Ka ende një dominim të mjekëve. Universiteti duhet të bëjë përpjekje që të punësojë njerëz nga një sferë më e gjerë profesionale të infermierisë. Vetëm profesionistët kompetentë për fushat e tyre përkatëse mund të garantojnë edukim cilësor. Kjo është arsyea pse është esenciale punësimi i një numri të duhur të infermierëve me shkollim akademik. Duke mos pasur askënd me doktoraturë në infermieri, gjatë intervistave me stafin ne theksuam rëndësinë e shkollimit akademik për infermierët.

Stafi mësimdhënës për programin e infermierisë duhet të jenë doktorantë apo magjistra në fushat relevante dhe secila fushë duhet të mbulohet nga profesorë me orar të plotë. Më tutje, 50% e tërë stafit mësimdhënës duhet të punësohet me orar të plotë nga institucioni. Momentalisht, këto kërkesa nuk janë përmbushur nga shumica. Fatkeqsisht nuk ka asnjë infermier me

edukim akademik të punësuar në Univeritetin e Gjakovës, edhe pse ka mjaft persona të tillë përreth.

I bëjmë thirrje udhëheqësisë së universitetit që të organizojë gjërat siç duhet, ose EE nuk do të jetë në gjendje të mbështesë riakreditimin.

Hulumtimi dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar

UGJFA momentalisht nuk ka ndonjë bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e infermierisë, por ata planifikojnë të nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Shtetëror të Tiranës, Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Universitetin Mjekësor të Tiranës, Universitetin e Vlorës "Ismail Qemali", Universitetin e Tetovës, Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka" dhe Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti". Ata kanë planifikuar gjithashtu tre aktivitete hulumtuese të tituluara: "Konceptet bazike të personit, shëndetit, sëmundjeve dhe rolit të infermierit në shëndetësi bazike", "Sistemi i funksionimit të mbikqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në Kosovë" dhe "Menagjimi i stresit në punë".

Finance and Infrastructure

Një buxhet është në dispozicion. Gjatë vizitës në institucion EE kërkoi që të shihte pajisjet laboratorike për studentët. Dhoma e mësimit për shkathtësitë infermierike është tërësisht e pajisur, me shumë manekinë dhe modele. Infermiera ka kushte relativisht të mira për zbatimin e planprogramit, edhe pse shumica e mësimeve teorike dhe praktike mbahen në premisat e institucionit. Kapacitetet ekzistuese infrastrukturale të UGJ mundësojnë një zhvillim normal të mësimit për rreth 50 studentë për çdo vit akademik. Ka një klasë për mësim, një për ligjerata, një bibliotekë dhe një kabinet të informatikës. Biblioteka nuk posedon literaturë të mjaftueshme për infermieri, kështu që i propozojmë udhëheqësisë së unviersitetit që sa ma shpejtë ta sigurojë atë.

Menagjimi i Cilësisë

UGJ ka një system të sigurimit të cilësisë i cili drejtohet nga Zyra për Sigurim të Cilësisë. Kjo zyrë menagjohet nga koordinatori për sigurim të cilësisë i cili në të njëjtën kohë është përgjegjës për sigurim të cilësisë për të gjitha programet. Ata do të përdorin pyetësorë që të masin cilësinë e mësimdhënjes dhe procesit të mësimit në institucion. Pyetësori vlerëson institucionin si tërësi dhe do t'iu shpërndahet studentëve në fund të vitit akademik.

vi. Programi Bachelor në Mami

Prof.Dr.Danica Železnik (Univ. College of Health Sciences Slov. Gradec, Slovenia)

Punëtorët profesionalë të mamisë janë profesionistë të cilët janë përgjegjës për detyrat (kompetencat) dhe përgjegjësinë për ofrimin e ndihmës së përgjithshme të infermierisë në Obstetri-Gjinekologji, në gadishmëri të problematikave mjekësore të individit dhe komunitetit, të cilët janë në gjendje të japin përkujdesje infermierie në Obstetri – Gjinekologji, preventivë, shërim, trajtim dhe rehabilitim. Mamitë janë persona të cilët kryejnë veprime direkte me autonomi profesionale.

Universiteti duhet të punojë drejtë punësimit të një rangu më të gjerë të profesionistëve në fushën e Mamisë.

Programet Akadematike dhe Menagjimi i Studentëve

Studimet në programin e mamisë janë me orar të plotë. Programi zgjat 3 vite (180 ECTS) dhe është i ndarë në 6 semestra (1 semestër ka 30 ECTS). Të gjitha lëndët vlejnë një numër kredish ECTS, dhe 1 kredi vlen 30 orë. Në secilin vit akademik, studentët mbajnë 15 javë mësimi në semestrin e parë dhe 15 në semestrin e dytë.

Planprogrami i plotë përmban gjithsej 5.400 orë mësimi, nga të cilat 1.950 orë në amfiteatër (ligjerata, seminare, ushtrime laboratorike) nga 45 minuta, 2.600 orë praktikë në institucione të shëndetësisë (spitale, klinika) dhe 850 orë mësim i pavarur.

Ky program bën pjesë në ciklin e parë të studimeve. Në fund të vitit të tretë të ciklit akademik, studentët mbrojnë Temën e Diplomës. Pas dimplomimit, studentët marrin: Diplomë (titulli): diplomë bachelor në "Mami".

Elementet teorike të programin janë të shkëlqyeshme. Mësimi klinik dhe praktik ka nevojë për më shumë strukturë, rezultate të pritura të të nxënit më të qarta dhe lidhje më të zhvilluar me mësimin akademik.

Universiteti zbaton kritere të duhura të pranimit për të qenë në pajtim me direktivat e BE-së, por vëmendje më e madhe duhet t'i kushtohet elementeve të trajnimit në mënyrë që të përkojnë me standardet ndërkombëtare, veçanërisht në fushat e zhvillimit praktik. Direktivat e BE-së theksojnë se shtatzania normale nuk ka nevojë për intervenim mjekësor dhe duhet të asistohet vetëm nga mamitë. Për të arritur këtë kompetencë, ato duhet të asistojnë në 40 lindje, të njohin shenja të shtatzanisë jonormale dhe të japin referime të duhura për obstetrikët.

Trajnimi praktik dhe klinik

Ky trajnim duhet të kryhet nën mbikqyrjen e duhur:

- Këshillimi i femrave shtatzëna, duke përfshirë së paku 100 egzaminime para lindjes.

- Mbikqyrja dhe përkujdesja për së paku 40 femra shtatzënë.
- Pjesëmarrje nga studenti në të paktën 40 lindje; nëse ky numër nuk mund të arrihet si pasojë e mungesës së rasteve të lindjes; mund të refuktohet në minimum 30; nëse sigurohet se studenti asiston në 20 lindjet e ardhshme
- Pjesëmarrje aktive në lindjet për se mprapshti. Nëse kjo nuk është e mundur për shkak të mungesës së lindjeve të tilla, mund të bëhet ushtrimi me situata të simuluar.
- Ecuria e epiziotomisë dhe fillimi i të prerjes. Fillimi do të përfshijë udhëzime teorike dhe praktikë klinike. Praktika e prerjes përfshin prerjen e një plaje që pason me një epiziotomi dhe një gërvishtje të thjeshtë perineale. Kjo mund të jetë në një situatë të simuluar nëse është absolutisht e nevojshme. Mbikqyrja dhe përkujdesja për 40 femra të rrezikuara në shtatzani, ose gjatë lindjes, ose në periudhën pas lindjes.
- Mbikqyrja dhe përkujdesja (duke përfshirë egzaminimin) për të paktën 100 femra pas lindjes dhe fëmijët e sapo-lindur në gjendje të shëndetshme.
- Vërtetimi dhe kujdesja për të sapolindurit në nevojë për përkujdesje të veçantë, duke përfshirë ata të lindur para kohës, pas kohës, nënprishje apo me sëmundje.
- Përkujdesja për femrat me gjendje patologjike në fushën e gjinekologjisë dhe obstetrisë.
 - Hyrje në përkujdesje në fushën e mjekësisë dhe operimit. Fillimi duhet të përfshijë udhëzime teorike dhe praktikë klinike.

Trajnimi teorik dhe praktik duhet të balancohet dhe koordinohet me trajnimin klinik.

Udhëzimet klinike duhet të mbahen në formë të trajnimeve shërbimore të mbikqyrura në departamente spitalore apo shërbime tjera shëndetësore të aprovuara nga autoritetet apo organet përkatëse. Si pjesë e këtij trajnimi, studentët në mami duhet të marrin pjesë në aktivitete të departamenteve vetëm përderisa aktivitetet në fjalë kontribuojnë në trajnimin e tyre. Atyre duhet të iu mësohen përgjegjësitë që shkojnë bashkë me punën e mamive.

Të dy grupet, si për mësim teorik si praktik, janë shumë të mëdha për një mësim cilësor.

Stafi

Stafi është shumë akademik dhe i dominuar nga mjekët. Raporti në mes numrit të studentëve dhe mësimdhënësve është shumë i ulët, në mungesë të mamive me shkollim akademik. Fatkeqsisht nuk ka asnjë mami me shkollim akademik të punësuar në Universitetin e Gjakovës, edhe pse ka mjaft persona të tillë përreth. Universiteti duhet të bëjë përpjekje që të punësojë njerëz nga një sferë më e gjerë profesionale të mamisë. Udhëheqja duhet të vijë nga profesionistë të denjë.

Hulumtimi dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Ka shumë pak dëshmi se studentët përfshihen në hulumtim apo në ndonjë auditim klinik si mjete mësimore. Duket se studentët nuk bëjnë praktika të bazuara në dëshmi dhe ky është një mjet që duhet të zhvillohet në mënyrë që të pasqyrojë standardet ndërkombëtare. Universiteti do të përfitonte nga krijimi i lidhjeve të reja dhe më të gjera ndërkombëtare në të gjitha programet.

Ndërtimi i lidhjeve ndërkombëtare për studentët që të zhvillojnë shkathtësitë e tyre do të ishte shumë e dobishme por kjo nuk duket se është duke ndodhur momentalisht. Universiteti do të përfitonte vërtetë nëse do përqëndrohej në këtë fushë. Universiteti ka planifikuar aktivitete hulumtuese me titujt: "Koncepte themelore mbi personat, shëndetësinë, sëmundjet dhe rolin e mamive në përkujdesjen bazike", "Funksionimi i sistemit të mbikqyrjes të SST në Kosovë" dhe "Menagjimi i stressit në punë".

Financat dhe Infrastruktura

Ndërtesa është e madhe dhe ka një numër të mjaftueshëm të klasave, por disa nga to nuk janë të pajisura mire dhe janë në gjendje shumë të dobët. Universitetit i duhen shumë burime financiare për rinovim. Bibloteka ishte shumë e mangët.

Menagjimi i Cilësisë

UGJ ka një system të sigurimit të cilësisë i cili drejtohet nga Zyra për Sigurim të Cilësisë. Kjo zyrë menagjohet nga koordinatori për sigurim të cilësisë i cili në të njëjtën kohë është përgjegjës për sigurim të cilësisë për të gjitha programet. Ata do të përdorin pyetësorë që të masin cilësinë e mësimdhënjes dhe procesit të mësimin në institucion. Pyetësori vlerëson institucionin si tërësi dhe do t'iu shpërndalet studentëve në fund të vitit akademik.

Recommendations:

- Stafi mësimdhënës për të dy programet duhet të jenë magjistra apo doktorantë në fushat përkatëse dhe secila fushë duhet të mbulohet nga një profesor me orar të plotë.
- Rekomandohet që programi të caktojë një infermier apo një mami për t'i udhëhequr programet. Është e vështirë të zgjedhet një infermier apo një mami e diplomuar, kështu që rekomandohet që universiteti të shqyrtojë mundësinë për të caktuar një grup ndërkombëtar për të

udhëhequr dhe zhvilluar mësimdhënësit në këto fusha që të çojnë programin përpara.

- Për më tepër, 50% e stafit mësimdhënës duhet të punësohet me orar të plotë nga institucioni. Momentalisht kjo kërkesë nuk përmbushet nga shumica.
- Studentët duhet të njoftohen me konceptin e praktikës së bazuar në evidencë dhe vlerësimin klinik si përmirësim i praktikës dhe metodologjive të mësimdhënës.
- Kohëzgjatje më e shkurtër, mësim praktik një me një dhe grupe të vogla mësimi me pacientë do të ngrisin cilësinë e mësimin.
- Akomodime më të mira për mësim të pavarur, siç është biblioteka, janë shumë të rëndësishme.
- Ndërtesat dhe pajisjet e mësimin janë shumë të vjetëruara dhe kërkohet një rinovim i menjëhershëm.

vii. Programi Bachelor në Fizioterapi

Prof.Dr.Danica Železnik (Univ. College of Health Sciences Slov. Gradec, Slovenia)

Informata të Përgjithshme

Në vitin akademik 2011/2012 Fakulteti i Mjekësisë në Prishtinë hapi degët e tij në Gjakovë me programet e Infermierisë dhe Mamisë. Në po atë vit akademik ata iu mundësuan regjistrimin studentëve të ri. Ndërsa për vitin që vjen, ata shpresojnë të fillojnë me një program në Fizioterapi.

UGJFA theksoi se programet e studimit janë të krahasueshme me ato të Fakultetit të Mjekësisë, Departamenti: Fizioterapi, Prishtinë, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti: Fizioterapi, Zagreb, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti: Fizioterapi, Bukuresht, por krahasimi nuk është bërë. Ata dëshirojnë të pranojnë 120 studentë në vit, gjë që nuk është e pranueshme.

Programet Akademike dhe Menagjimi i Studentëve

Studimet në programin e mamisë janë me orar të plotë. Programi zgjat 3 vite (180 ECTS) dhe është i ndarë në 6 semestra (1 semestër ka 30 ECTS). Të gjitha lëndët vlejnë një numër kreditësh ECTS, dhe 1 kredi vlen 30 orë. Programi është duke mbajtur ciklin e parë të studimeve.

Titulli i gradës akademike: Bachelor në Fizioterapi

Ndërtimi i planprogramit NUK përkon me standardet e Bolonjës (ndarja sistematike e lëndëve, ligjerata, seminare, detyra, trajnime klanike me pacientë të vertetë, si dhe studime të pavarura në shtëpi).

Programi ka shumë gabime, p.sh në faqën The 312: *“Përmbajtja e programit është në pajtim të plotë me kërkesat evropiane për një program të duhur trajnimi në **infermieri**. Në planprogramin tonë, **përkujdesja në infermieri** është e lidhur me secilën lëndë në veçanti, duke i bërë kështu ato të lidhura me njëra-tjetrën.”* – është e qartë se kjo është kopjuar fjalë për fjalë nga programi i infermierisë.

Stafi

Stafi është shumë i shkolluar akademikisht dhe i dominuar nga mjekët. Raporti në mes numrit të studentëve dhe mësimdhënësve është shumë i ulët, në mungesë të fizioterapistëve me shkollim akademik. Fatkeqsisht nuk ka asnjë fizioterapeut me shkollim akademik të punësuar në Univeritetin e Gjakovës, dhe i tërë stafi duhet të vijë nga institucione tjera, kryesisht nga Universiteti i Prishtinës, gjë që nuk është e pranueshme.

Hulumtimi dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar

UGJFA ka planifikuar programet e hulumtimit në vijim: “Konceptet bazike të personit, shëndetit, sëmundjeve dhe rolit të fizioterapeutit në përkujdesje bazike”; “Sistemi funksional i mbikqyrjes së sëmundjeve ortopedike-traumatologjike në Kosovë”, “Menagjimi i stressit në punë” – që janë të njejta si në të gjitha programet.

Financat dhe Infrastruktura

Ndërtesa është e madhe dhe ka një numër të mjaftueshëm klasash, mirëpo disa prej tyre janë në gjendje dhe me pajisje shumë të dobët. Universitetit i duhën burime të mëdha financiare për rinovim. Bibloteka ka një numër shumë të kufizuar të titujve. UGJFA theksoi se hapësira është e bollshme dhe e rehatshme, por që nuk është në gjendje të mirë dhe nuk është e përshtatshme për mësim. Për programin e fizioterapisë, nuk ka as të paktën një hapësirë të pajisur dhe të përshtatshme për mësim.

Menagjimi i Cilësisë

UGJ ka një system të sigurimit të cilësisë i cili drejtohet nga Zyra për Sigurim të Cilësisë. Kjo zyrë menagjohet nga koordinatori për sigurim të cilësisë i cili në të njejtën kohë është përgjegjës për sigurim të cilësisë për të gjitha programet.

Rekomandime:

Pas një shqyrtimi të plotë të dokumentacionit dhe analizimit të të gjitha rrethanave tjera të nevojshme, EE vëren se Fakulteti i Mjekësisë nuk i ka përmbushur kushtet për akreditimin e programit të Fizioterapisë. Pajisjet për mësimdhënje janë në gjendje shumë të keqe. Nevojitet gjithashtu një kabinet ku student mëson aktivitete fizioterapeutike para se të ketë të bëjë me pacientin. UGJ nuk posedon një kabinet të tillë. Problemi më i madh është mungesa e tërësishme e stafit mësimdhënës kompetent nga Prishtina, gjë që nuk është e pranueshme..

Për mendimin tonë, më së miri do të ishte që Fakulteti i Mjekësisë të mbahet nën ombrellën e Universitetit të Prishtinës.

REKOMANDIMET PËRFUNDIMTARE për programet në Infermieri, Mami dhe Fizioterapi

- Programet ekzistuese në Infermieri dhe Mami duhet të akreditohen për një periudhë dy vjeçare (EE është i vetëdijshëm se periudha normale e akreditimit është 3 vjeçare. Sidoqoftë, do të jetë e nevojshme të kontrollohet shkollimi akademik i të punësuarëve në këto dy fusha)
- Programi i Fakultetit të Mjekësisë në Fizioterapi NUK duhet të akreditohet.

viii. Bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze

Prof. Dr. Philip Coleman (Trinity College, University of Dublin, Ireland)

Hyrje

Siç është theksuar në *Raportin e Vetë-Vlerësimit* (f 369), programi bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze është akredituar nga AKA në prill të vitit 2013. Për momentin, 80 studentë vazhdojnë studimet në këtë program, i cili drejtohet nga Prof.Dr.Shpresa Hoxha.

Stafi

Ishte kënaqsi të takohemi me Prof.Dr.Hoxha gjatë vizitës në institucion, por ishte zhgënjyes fakti që ajo ishte e vetmja përfaqësuese nga ky program prezente në takim, sidomos pasi që një numër i mësimdhënësve ishin prezente në një takim të mëvonshëm. Prof.Dr.Hoxha ka një karrierë të bujshme si mësimdhënëse dhe hulumtuuese në Kosovë, si dhe ka gjithashtu lidhje të forta me Universitetin e Prishtinës. Gjatë takimit ajo shpjegoi se të gjitha detajet në lidhje me programin në Gjuhë dhe Letërsi Angleze në RVV

janë marrë nga dokumente të hartuara në UP. Sidoqoftë, gjatë diskutimit u sqarua se ka një raport të duhur të stafit (të përhershëm dhe të jashtëm) për të dhënë këtë program, dhe i gjithë stafi ka kualifikimet e duhura për pozicionet e tyre përkatëse si mësimdhënës në Universitetin e Gjakovës.

Planprogrami

Planprogrami është shumë i kënaqshëm, si në shpërndarjen e ECTS-ve si në përmbajtjen e tij.

Hulumtimi dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Gjatë vizitës në institucion nuk qe e mundur të nxjerrej ndonjë kuptim i plotë i gamës së hulumtimit apo bashkëpunimit ndërkombëtar të ndërmarrur nga stafi i programit. Prof.Dr.Hoxha është dukshëm e angazhuar në hulumtime të vlefshme, dhe CV-të e pjesës tjetër të stafit tregojnë se janë të angazhuar në disa projekte të rëndësishme, por gjatë vizitës nuk ishte e mundur të diskutohej me stafin në lidhje me këtë çështje. Duke u bazuar në materialin e përmbajtur në RVV, duket se niveli i bashkëpunimit ndërkombëtar sa i përket programit në Gjuhë dhe Letërsi Angleze është shumë i ulët, por ka hapësirë për zhvillim në këtë aspekt në të ardhmën gjatë zhvillimit të UGJ si institucion i pavarur regional për arsim të lartë.

Financat dhe Infrastruktura / Hapësira dhe Pajisjet/ Biblioteka

Klasat e mësimi për studimet e gjuhës dhe letërsisë angleze në UGJ janë të kënaqshme, por biblioteka ka nevojë serioze për përmirësime, si në numër të librave ashtu edhe në hapësirën për studim, për studentët dhe për stafin. Universiteti i Gjakovës ka një plan të mirë buxhetor, dhe thuhet se programi në Gjuhë dhe Letërsi Angleze konsiderohet si një pjesë e rëndësishme e planeve të ardhshme të institucionit.

Përmbledhje

Programi bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze siç është përshkruar në RVV është shumë i kënaqshëm sa i përket planprogramit. Ai gjithashtu drejtohet nga një shkollare dhe akademike e shkëlqyeshme (Prof.Dr.Hoxha), dhe duket qartë se ajo ka mbështetjen e një grupi shumë kompetent të kolegëve, edhe pse shumë nga këta janë asistentë dhe anëtarë të stafit me gjysmë-orari. Mbetet të shpresohet se iniciativat e kohës së fundit për punësim në UGJ do të sjellin pozita permanente të stafit në Gjuhë dhe Letërsi Angleze në mënyrë që programi të ketë një presencë më të fortë dhe më të dukshme në kampusin e Universitetit. Idealisht, duhet të ketë edhe të paktën një person që ka gjuhën angleze si gjuhë amëtare. I rëndësishëm së njejtë sa i përket zhvillimit të programit do të ishte punësimi i shkollarëve dhe akademikëve me prapavijë të pasur në hulumtime në fushat drejtpërdrejtë të lidhura me planprograme në gjuhën dhe letërsinë angleze. Në fund, biblioteka duhet të zgjerohet dhe të pasurohet urgjentisht. Për

momentin studentët duken të kënaqur me disponueshmërinë e librave në bibliotekë, por për standard ndërkombëtare biblioteka për gjuhë dhe letërsi angleze është shumë e varfer dhe nuk ofron baza adekuate për studime apo hulumtime për studentët apo stafin e përfshirë në këtë program.

Rekomandime:

- Rekomandohet ri-akreditim 2 vjeçar për programin bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Në fund të asaj periudhe këshillohet një rishqyrtim më i qartë i programit, i cili do të merrte parasysh të gjitha pikat e lartpërmendura, veçanërisht sa i përket stafit, hulumtimit dhe bibliotekës. Vlerësimi pozitiv i bërë në këtë rast mbështetet në repurationin e Prof.Dr.Hoxha dhe cilësinë e studentëve të intervistuar, bashkë me vetëdijën që UGJ është momentalisht në fazë tranzicioni. Nëse programi bachelor në Gjuhë dhe Letërsi Angleze do të mirret seriozisht në të ardhmën, vlerësuesit e ardhshëm duhet të binden që rekomandimet e bëra në këtë raport janë zbatuar saktësisht sipas çdo detaji.

Agjensia e Akreditimit të Kosovës / KAA

Universiti i Gjakovës "Fehmi Agani" Fakulteti i Filologjisë Programi Studime në Letërsinë Shqipe

Ekspert: Prof. Dr. Shezai RROKAJ

Raporti Përfundimtar i Vlerësimit mbështetet në:

1. Raportin vetvlerësues të Institucionit 31.12.2103, Gjakova.
2. Takimet me Dr. Kamber Kamberi, dhe Dr. Frederik Dulaj.
3. Dokumentacionin shtesë.
4. Komentet e Institucionit

Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentit - Analizë dhe Rekomandime

Ky raport vlerësimi përmban rekomandime dhe analizë, lidhur me Programin Studime të Letërsisë Shqipe, në përputhje me kërkesat e paraqitura në udhëzuesin e Agjensisë së Akreditimit të Kosovës, të Programit Akademik dhe Menaxhimit të studentit. Procesi i vlerësimit të këtij Programi Studimor mban parasysh çështje si: analizën e programeve akademike, përbërjen e stafit akademik, përmbajtjen e kurrikulës në fusha të ndryshme studimi, etj.

Në kuadër të vlerësimit, duke marrë parqasysh përputhjen që ekziston midis Misionit të këtij Institucioni dhe objektivave të programit të studimit si dhe të nismës që ky Institucion ka ndërmarrë për krijimin e një dege të re në Fakultetin e Filologjisë: përkatësisht Studime në Letërsinë Shqipe, shprehemi se vlerësimi ynë është pozitiv. Përgjithësisht, ky program studimi u përgjigjet standardeve evropiane që lidhen me procesin e edukimit dhe mësimdhënies. Parimi kryesor i Diplomës Bachelor sipas Sistemit të Bolonjës është parimi drejtues mbi të cilin është mbështetur programi Studimi të Letërsisë Shqipe. Gjithashtu, kërkesa në rritje për të përmbushur nevojat e shoqërisë në Kosovë për përdorues dhe njohës të

kualifikuar të gjuhës dhe letërsisë shqipe në insitucione qeveritare dhe jo-qeveritare ka bërë që kjo iniciativë të vlerësohet dhe si një mekanizëm i përshtatshëm për të kontribuar në zhvillimin social të kësaj shoqërie. E thënë ndryshe, ky program studimi shprehet qartë dhe përputhet me parimet e punësimit

Nga ana tjetër, komentet e Institucionit konfirmojnë gatishmërinë e tyre për vazhdimësinë e përbushjes së rekomandimeve dhe përputhjes së Misionit të Institucionit me parimet e punësimit.

Lidhur me përputhjen që ekziston midis kualitetit dhe synimeve akademike të kësaj kurrikule me gradën akademike duhet të themi se struktura e programit të Studime në Letërsinë Shqipe paraqitet e mirëorganizuar dhe në përputhje me qëllimet e studimit. Gjithashtu ky program është i krahasueshëm me kriteret ndërkombëtare të vlerësimit të procesit të edukimit dhe mësimdhënies.

Në materialet që ne disponojmë paraqitet qartazi interesi që Fakulteti i Filologjisë i kushton krijimit të programit të studimit, Bachelor, në Studime në Letërsinë Shqipe. Edhe pse, kjo përpjekje duhet vlerësuar si e kënaqshme, rekomandojmë se një hap i rëndësishëm për arsimin e lartë është dhe qartësimi i vizionit të këtij Institucioni arsimor lidhur me vijimësinë organike të tre cikleve të studimit: Bachelor, Master dhe Doktoraturë. Vetëm duke pasur një vizion të qartë të vijimësisë të këtyre tre cikleve atëherë Misioni i këtij Institucioni do të jetë në përputhje me realizimin e qëllimeve dhe objektivave të tij akademike.

Pa dyshim që Universiteti i Prishtinës është parë si një udhërrëfyes për ndërtimin e vizionit të këtij Institucioni për të arritur qëllimet e tij, por ne sugjerojmë se, me kalimin e kohës, kurrikula akademike e këtij Departamenti duhet të ketë identitetin e saj, në mënyrë që plan programi të fitojë origjinalitet dhe të nxisë më mirë rritjen e cilësisë akademike si dhe të jetë në përputhje me diplomat e dhëna nga ky Institucion.

Për sa më sipër në komentet e Instucionit konstatohet një përputhje e plotë me të gjithë komponentët e sugjerimeve tona.

Përsa i përket konceptit didaktik të paraqitur në programin e Studime në Letërsinë Shqipe vlerësojmë se në këtë program studimi i jepet përparësi performancës së studentit, jo vetëm gjatë përfshirjes së tij në vitet e studimit, por dhe në të ardhmen, si pjesë e rëndësishme e jetës shoqërore dhe publike. Përgjithësisht, ky program studimi i paraqitur nga stafi akademik mbështetet mbi një koncept didaktik, por vihen re disa probleme, të cilat lidhen strukturën e tij. Këto probleme nevojiten të korrigjohen nga ky staf mësimdhënës. Në mënyrë të detajuar ato janë listuar në pjesën e fundit të këtij raport vlerësimi në rubrikën Rekomandimeve shtesë për secilën lëndë.

Lidhur me titujt akademikë që garanton ky Institucion shprehemi se vlerësimi ynë është pozitiv, pasi këta tituj i përgjigjen standardeve ndërkombëtare, përkatësisht sistemit të Bolonjës. Si një komponent i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit të studimit vlerësohet dhe ndërthurja e praktikës me teorinë. Gjithashtu, është bërë një përlllogaritje e drejtë që midis tyre, ku 60% e kohës së studimit ka në fokus teorinë dhe 40% e kohës së këtij studimi i kushtohet praktikës, gjë që që të mundëson përgatitjen e studentit në përputhje me nevojat e tregut të punës në Kosovë. Shpërndarja e krediteve është e qartë dhe e pranueshme. Sigurisht kjo përputhje e programeve dhe Cikleve të studimit me standardet ndërkombëtare mbështetet dhe në eksperiencat e Universiteteve të rajonit si p.sh, Universitetit të Prishtinës, Tiranës, Tetovës, Kroacisë etj.

Edhe në komentet e Institucionit pranohet ky rekomandim për një plan strategjik lidhur me përputhjen e titujve me standardet ndërkombëtare, i cili pritet të miratohet nga organet përgjegjëse të Universitetit.

Përsa i përket strukturës së programit, ajo mundëson dhe lejon përgatitjen e pavarur të studentit për të zgjeruar dhe përmirësuar njohuritë e tij në lidhje me këtë fushë studimi. Gjithashtu koha që studenti kalon në auditor dhe jashtë tij, është përlogaritur drejt dhe në përputhje me vlerësimin e çdo lënde, sipas shpërndarjes përkatëse të krediteve.

Shpërndarja e krediteve është plotësisht e drejtë dhe e justifikueshme, për çdo semestër dhe vit akademik. Por sugjerimi ynë lidhet me zhvendosjen e lëndëve të veçanta midis semestrit të tretë të vitit të dytë akademik ku numri total i krediteve paraqet probleme, faqja 426 e raportit vetvlerësues të Institucionit. Shuma e krediteve të lëndëve të detyruara dhe atyre me zgjedhje nuk përputhet me numrin 30, të krediteve të një semestri të plotë.

I njëjti fenomen vërehet dhe për semestrin e katërt të vitit të dytë akademik, si dhe për semestrin e pestë të vitit të tretë akademik, faqja 427 të raportit vetvlerësues të Institucionit.

Megjithatë çdo ndryshim i sugjeruar kërkon vëmendje të veçantë përpara se të bëhet pasi duhet të merret në konsideratë ruajtja e numrit total të krediteve, 180, për Ciklin e parë të studimeve, Bachelor.

Në komentet e Institucionit lidhur me rekomandimet tona vihet re dakortësia e tyre për secilin sugjerim përkatës të çështjeve të sipërpërmendura.

Një tjetër çështje ku jepen rekomandimet tona është dhe ngarkesa e punës dhe menaxhimi i saj nga ana e studentit. Vlerësimi i performancës së studentit në faza të ndryshme të ecurisë së procesit mësimor është një provë bindëse, e cila paraqet si dhe sa kjo ngrakesë studimore është e përballueshme dhe e menaxhueshme prej studentit. Ky vlerësim pasqyrohet në mënyrë të detajuar në plan programet e secilës lëndë.

Në komentet e Institucionit konstatohet një pranim i rekomandimit tonë lidhur qasjen e Institucionit.

Lidhur me vlerësimin tonë për metodat e mësimdhënies dhe përmbajtjen e temave, që do të trajtohen gjatë Ciklit të parë të studimit, vlerësojmë se ato janë paraqitur në plan program dhe janë të mirorganizuar, por theksi duhet vënë në nevojshmërinë që paraqitet për përditësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së këtyre metodave. Mënyra më e mirë për të realizuar këtë gjë përcaktohet pikërisht nga feedback-u, që sigurohet nëpërmjet fazave të ndryshme të vlerësimit të performancës së studentëve. Vetëm në këtë mënyrë do të arrihen qëllimet dhe objektivat e përcaktuara nga ky program akademik qysh në fillim të krijimit të tij.

Institucioni në komentet e tij shprehet se metodologjia e mësimdhënies do të ndryshojë sipas metodologjive bashkëkohore, gjë të cilën ne e inkurajojmë.

Përsa i përket transparencës së procesit akademik, i realizuar nëpërmjet përmbajtjes së programeve të çdo lënde të pasqyruar në kurrikulë, e vlerësojmë si të qartë dhe të përshtatshme.

Për këtë pikë Institucioni komenton se Strukturat përkatëse të Universitetit do të zgjidhin çdo ngërç të mundshëm gjatë rrugës së zhvillimit të procesit akademik.

Kriteri i pranimit të studentit në Ciklin e Parë të studimeve universitare është një çështje problematike, e cila kërkon vëmendje të veçantë. Në bazë të dokumentave që ne disponojmë studentët që vendosin të fillojnë studimet në Studime të Letërsisë Shqipe aktualisht, kanë të drejtën për të vazhduar studimet e larta në Fakultetin e Filologjisë, pasi kanë përfunduar shkollën e mesme. Ajo çka rekomandojmë është pikërisht aplikimi i një testi pranimit, si pjesë e rregullores së këtij Fakulteti, i cili do të testojë njohuritë e shkollës së mesme të studentit/es para se të pranohet në studimet e larta në këtë fushë studimi.

Lidhur me këtë rekomandim, Institucioni komenton se për këtë çështje paraqiten kriteret e vlerësimit, duke u përllogaritur në: 50% Testi i Maturës; 20% Mestarja e shkollës së Mesme dhe 30% Testi i Pranimit në Universitete. Kjo mënyrë pranimit e testimi është plotësisht në përputhje me standardet për pranimet në universitet të studentëve në këtë program studimi.

Personeli Akademik- Analizë dhe Rekomandime

Si një pikë e rëndësishme duhet vlerësuar dhe bashkëpunimi i secilit prej Fakulteteve me Departamentet e tyre përkatëse, duke patur parasysh faktin se këta të fundit janë bërthama e procesit të edukimit dhe mësimdhënies, si dhe kërkimit shkencor. Nga njëra anë, rritja e numrit të këtyre departamenteve duhet vlerësuar si një shtysë thelbësore për përmirësimin e arsimit të lartë, dhe, nga ana tjetër, numri i madh i pedagogëve të angazhuar me kohë të pjesshme nuk favorizon kërkimin shkencor dhe startegjinë e tij brenda këtyre departamenteve.

Përpara se të vijojmë me rekomandime konkrete lidhur me angazhimin e stafit akademik në përputhje me numrin e studentëve, vlerësojmë si një rekomandim të veçantë pajisjen me informacion të plotë të Organigramës së këtij Fakulteti. Sipas pohimeve të Institucionit aktualisht, nga 33 pedagogë të angazhuar nga Departamenti i Letërsisë Shqipe vetëm 3 prej tyre janë punësuar me kohë të plotë. Pjesa tjetër është e angazhuar me kohë të pjesshme. Për një shpërndarje të drejtë të ngarkesës mësimore si dhe ruajtjen e cilësisë së procesit të mësimdhënies rekomandojmë që 1 pedagogë duhet të ngarkohet me 2 deri në 3 lëndë, pasi një ngarkesë më e madhe ndikon negativisht në përfshirjen konkrete të tij në punë kërkimore-shkencore.

Në komentet e Institucionit vihet re premtimi i tyre për një rritje të numrit të pedagogëve të angazhuar me kohë të plotë në mënyrë që, të arrihet standardi 1 pedagogë për 18/20 studentë. Gjithashtu premtohet se deri në arrijtjen e këtij standardi, Universiteti i Prishtinës do të jetë në mbështetje të plotë të Institucionit. Megjithatë, rekomandojmë verifikimin hap pas hapi të këtij premtimi nga KAA nëse ky kriter do të plotësohet.

Aktualisht në përbërjen e personelit akademik të Departmentit të Letërsisë Shqipe sipas titujve janë: 6 profesorë doktorë; 12 profesorë asistentë, 5 doktorë dhe 10 master. Padyshim që kjo përbërje vlerësohet si e kënaqshme. Megjithatë rekomandohet që pjesës së personelit akademik që ka titullin Master t'i mundësohet hapësira dhe kushtet për të vazhduar Ciklin e tretë të studimeve doktrale. Përmeshja e kësaj detyre do të çojë drejtëpërsëdrejti në përmirësimin e procesit mësimdhënës.

Lidhur me kërkesën tonë për mosparaqitjen e CV-ve të disa pedagogëve në plan program, në komentet e Institucionit sqarohet se ky personel akademik synohet të punësohet

në të ardhmen. Ndërsa përsa i përket rekomandimeve të çështjes së personelit akademik për numër studentësh ato pranohen dhe premtohet se do të respektohen në të ardhmen.

Vlerësojmë angazhimin e Fakultetit të Filologjisë, posaçërisht të Departamentit të Letërsisë Shqipe, lidhur me organizimin e plan programit dhe strukturën e këtyre lëndëve, por rekomandojmë se duhet t'i jepet prioritet dhe rëndësi krijimit të një strategjie të kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Departamenti i Letërsisë Shqipe duhet të mendojë seriozisht lidhur me përfshirjen e personelit akademik në zhvillimin e një strategjie konkrete të punës kërkimore shkencore.

Në komentet e Institucionit lidhur me përfshirjen e stafit akademik në punë kërkimore-shkencore premtohet se Bordi Drejtues dhe Senati i këtij Institucioni do të zhillojnë një strategji të mirëfilltë kërkimore, të cilën e kemi vlerësuar qysh në fillim të këtij raporti si faktori kryesor për njësitë bazë të çdo Universiteti që janë pikërisht departamentet.

Megjithatë, për të patur një përfshirje më të madhe dhe produktive të studentit në kërkimin shkencor rekomandohet përmbushja e domosdoshme e nevojës për të patur një revistë kërkimore-shkencore periodike, të publikuar nga vetë Departamenti i Letërsisë Shqipe. Kjo iniciativë mund të jetë fryt dhe i këtij bashkëpunimi ndërkombëtar, i kërkimit shkencor në universitet, i përfshirjes së studentit në projekte të ndryshme kërkimore etj. Sigurisht vlerësojmë dhe inkurajojmë vazhdimësinë e bashkëpunimit edhe në fushën e kërkimit, që ekziston midis këtij Institucioni dhe Universitetit të Prishtinës.

Në komentin e Institucionit lidhur me çështjen e sipërpërmendur theksohet vendosmëria për ta çuar përpara këtë nismë.

Lidhur me pohimet e Institucionit për të garantuar për mbushjen e standardit 3 m²/studentë dhe se një ndërtesë e veçantë parashikohet vetëm për Fakultetin e Filologjisë duhet të themi se vlerësimi ynë është pozitiv, por rekomandojmë të mendohet për të gjetur zgjidhje afatgjatë për t'u përballur më së miri dhe përmbushur kërkesat e të ardhmes.

Si elemente kyç të çështjes së Faciliteteve duhet vënë theksi pikërisht tek shërbimi dhe aksesimi në variantin elektronik të burimeve dhe literaturave që mundëson Biblioteka e këtij Institucioni. Vlerësojmë literaturën ekzistuese në Letërsinë Shqipe që ndodhet dhe mundësohet në këtë Fakultet, por duhet të themi se është e pamjaftueshme për t'u pajtuar me kërkesat e studentit dhe personelit akademik në të njëjtën kohë. Është konfirmuar dhe duhet përgëzuar bashkëpunimi midis Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe asaj të Fakultetit, por ne rekomandojmë që ky akses elektronik i burimeve të literaturës bashkëkohore të mundësohet sa më parë si një komponent i rëndësishëm për përmirësimin në tërësi të procesit të edukimit dhe mësimdhënies e kërkimit.

Në komentet e Institucionit premtohen ndryshime dhe iniciativa të cilat vlejné për t'u vlerësuar dhe ndjekur hap pas hapi nga KAA, lidhur me mbajtjen e këtyre premtimeve.

Sigurimi i Cilësisë- Analizë dhe Rekomandime

Duke patur parasysh natyrën dinamike të kësaj fushe në Studime në Letërsinë Shqipe rekomandojmë vlerësimin e vazhdueshëm të programve që ky Institucion ofron. Vëmendje e veçantë duhet treguar në përputhjen e vlerësimit të jashtëm të programit me procesin e

brendshëm të vlerësimit në mënyrë që të shmanget çdo mospërputhje e sigurimit dhe menaxhimit të cilësisë.

Lidhur me këtë çështje Institucioni bie dakord, duke premtuar se do ndjekë me përpikmëri rekomandimin tonë.

Rekomandimet shtesë dhe të detajuara për përmbajtjen e çdo lënde janë dhënë lidhur me gabimet e dukshme gjuhësore të titujve të lëndëve të paraqitura në gjuhën angleze në Raportin vetvlerësues të këtij Institucioni.

Nëse ju nevojten detaje, i gjeni të përcaktuara qartazi në versionin në gjuhën angleze të këtij Raporti përfundimtar.

Përfundime

Në përfundim të këtij Raporti Përfundimtar Vlerësimi, është e rëndësishme që të theksojmë se disa prej çështjeve problematike të sipërpërmendura janë të riparueshme në kohë përpara se të fillojë viti akademik. Për këto çështje vetë Institucioni është shprehur në komentet e tij. Padyshim, zgjidhja e problemeve të tjera të mësipërme kërkon më shumë kohë.

Rekomandojmë akreditimin e programit të studimit Bachelor, në Studime të Letërsisë Shqipe për një periudhë prej tre vitesh, duke marrë në konsideratë ndryshimet që priten të bëhen lidhur me çështjet e trajtuara më sipër.

Agjensia e Akreditimit të Kosovës / KAA

Universiti i Gjakovës "Fehmi Agani"

Fakulteti i Filologjisë

Programi Studime në Gjuhën Shqipe

Ekspert: Prof. Dr. Shezai RROKAJ

Raporti Përfundimtar i Vlerësimit mbështet në:

1. Raportin vetvlerësues të Institucionit 31.12.2103, Gjakova.
2. Takimet me Dr. Kamber Kamberi, dhe Dr. Frederik Dulaj.
3. Dokumentacionin shtesë.
4. Komentet e Institucionit.

Programi Akademik dhe Menaxhimi i Studentit - Analizë dhe Rekomandime

Ky Raport Përfundimtar Vlerësimi përmban rekomandime dhe analiza, lidhur me Programin Studime në Gjuhën Shqipe, në përputhje me kërkesat e paraqitura në udhëzuesin e Agjensisë së Akreditimit të Kosovës, të Programit Akademik dhe Menaxhimit të studentit.

Në kuadër të vlerësimit, të përputhjes që ekziston midis Misionit të këtij Institucioni dhe objektivave të programit të studimit si dhe, nismës që ky Institucion ka ndërmarrë për krijimin e një Programi të ri në Fakultetin e Filologjisë, përkatësisht Studime në Gjuhën Shqipe, theksojmë se vlerësimi ynë është pozitiv. Përgjithësisht, ky program studimi u përgjigjet standardeve evropiane lidhur me procesin e edukimit dhe mësimdhënies. Parimi kryesor i Diplomës Bachelor sipas Sistemit të Bolonjës është parimi drejtues mbi të cilin është mbështetur programi Studime në Gjuhës Shqipe. Gjithashtu, kërkesa në rritje për të përmbushur nevojat e shoqërisë në Kosovë për përdorues dhe njohës të kualifikuar të gjuhës shqipe në insitucione qeveritare dhe jo-qeveritare ka bërë që kjo iniciativë të vlerësohet dhe si një mekanizëm i përshtatshëm për të kontribuar në zhvillimin social të kësaj shoqërie. E thënë ndryshe, ky program studimi shprehet qartë dhe përputhet me parimet akademike dhe nevojat e punësimit

Nga ana tjetër, komentet e Institucionit tregojnë gatishmërinë e tyre për vazhdimësinë e përmbushjes dhe përputhjes së Misionit të Institucionit me parimet e punësimit.

Lidhur me përputhjen që ekziston midis kualitetit dhe synimeve akademike të kësaj kurrikule me gradën akademike shprehemi se struktura e programit të Studime në Gjuhën Shqipe paraqitet e mirëorganizuar dhe në përputhje me qëllimet e studimit. Gjithashtu, ky program është i krahasueshëm me kriteret ndërkombëtare të vlerësimit të procesit të edukimit dhe të mësimdhënies e kërkimit.

Në materialet që disponojmë paraqitet qartazi interesi që Fakulteti i Filologjisë i kushton krijimit të programit të studimit, Bachelor në Studime në Gjuhës Shqipe. Edhe pse, kjo përpjekje duhet vlerësuar si e kënaqshme, rekomandojmë se një hap i rëndësishëm për arsimin e lartë është dhe qartësimi i vizionit të këtij Institucion arsimor lidhur me krijimin e tre cikleve të studimit: Bachelor, Master dhe Doktoraturë. Vetëm duke patur një vizion të qartë të vijimësisë të këtyre tre cikleve Misioni i këtij Institucioni do të jetë në përputhje me realizimin e qëllimeve dhe objektivave të tij akademike.

Pa dyshim që Universiteti i Prishtinës është parë si një udhërrëfyes për ndërtimin e vizionit të këtij Institucioni për të arritur qëllimet e tij, por ne rekomandojmë që, me kalimin e kohës, kurrikula akademike e këtij Departamenti duhet të ketë identitetin e saj, në mënyrë që plan programi të fitojë origjinalitet dhe të nxisë rritjen e cilësisë akademike si dhe të jetë në përputhje me diplomat e dhëna nga ky Institucion.

Në komentet e Institucionit miratohen në përputhje të plotë të gjithë elementet e rekomandimeve tona lidhur me çështjen e sipërpërmendur.

Përsa i përket konceptit didaktik të paraqitur në programin e Studime në Gjuhën Shqipe vlerësojmë se në këtë program studimi i jepet përparësi performancës së studentit, jo vetëm gjatë përfshirjes së tij në vitet e studimit, por dhe në të ardhmen, si pjesë e rëndësishme e jetës shoqërore dhe publike. Përgjithësisht, ky program studimi i paraqitur nga stafi akademik mbështetet mbi një koncept didaktik, por vihen re disa probleme, të cilat prekin strukturën e tij. Këto probleme nevojitet të korrigjohen nga stafi mësimdhënës. Rekomandime të detajuara janë listuar në pjesën e fundit të këtij raport vlerësimi, te Rekomandimet shitesë për secilën lëndë.

Duhet të themi se vlerësimi ynë lidhur me titujt akademikë që jep ky Institucion është pozitiv, pasi këta tituj u përgjigjen standardeve ndërkombëtare, përkatësisht sistemit të Bolonjës. Si një komponent i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit të studimit vlerësohet edhe ndërthurja e praktikës me teorinë. Përlllogaritja është bërë e drejtë midis tyre, ku 60% e kohës së studimit ka në fokus teorinë dhe 40% e kohës së këtij studimi i kushtohet praktikës. Kjo mënyrë mundëson përgatitjen e studentit në përputhje me nevojat e tregut të punës në Kosovë. Shpërndarja e krediteve është e qartë dhe e pranueshme. Sigurisht, kjo përputhje e programeve dhe Cikleve të studimit me standardet ndërkombëtare mbështetet dhe në eksperiencat e marra nga Universitetet e rajonit si p.sh, Universiteti i Prishtinës, Tiranës, Tetovës, Kroacisë etj.

Në komentet e Institucionit theksohet se ky plan strategjik lidhur me përputhjen e titujve me standardet ndërkombëtare pritet të aprovohet nga organet përgjegjëse të Universitetit.

Përsa i përket strukturës së programit, ajo mundëson dhe lejon përgatitjen e pavarur të studentit për të zgjeruar dhe përmirësuar njohuritë e tij në lidhje me këtë fushë studimi. Gjithashtu, koha që studenti kalon në auditor dhe jashtë tij, është përlllogaritur drejt dhe në përputhje me vlerësimin e çdo lënde, sipas shpërndarjes përkatëse të krediteve.

Shpërndarja e krediteve është plotësisht e drejtë dhe e justifikueshme, për çdo semestër dhe vit akademik. Por rekomandimi ynë lidhet me zhvendosjen e lëndëve të veçanta midis semestrit të dytë të vitit të parë akademik dhe semestrit të tretë të vitit të dytë akademik. Lënda e Morfologjisë, e cila zhvillohet në semestrin e dytë duhet të shkëmbehet me lëndën Shkrim Krijues, e cila zhvillohet në semestrin e tretë. Lënda e Sintaksës duhet të shkëmbehet me Lëndën e Dialektologjisë, e cila zhvillohet në semestrin e katërt.

Megjithatë, çdo ndryshim i sugjeruar kërkon vëmendje të veçantë përpara se të bëhet, pasi duhet të merret në konsideratë ruajtja e balancit të numrit të krediteve, 30 për çdo semestër.

Në komentet e Institucionit lidhur me rekomandimet tona vihet re dakortësia e tyre për secilin sugjerim përkatës të çështjeve të sipërmendura.

Një tjetër çështje për të cilën ne shprehim rekomandimin tonë është dhe ngarkesa e punës dhe menaxhimi i saj nga ana e studentit. Vlerësimi i performancës së studentit në faza të ndryshme të ecurisë së procesit mësimor është një provë bindëse, e cila paraqet si dhe sa kjo ngrakesë studimore është e përballeshme dhe e menaxhueshme prej studentit. Ky vlerësim pasqyrohet në mënyrë të detajuar në plan programet e secilës lëndë.

Në komentet e Institucionit konstatohet një miratim i rekomandimit tonë lidhur qasjen e Institucionit.

Lidhur me vlerësimin tonë për metodat e mësimdhënies dhe përmbajtja e temave që do të trajtohen gjatë Ciklit të parë të studimit vlen të themi se ato janë paraqitur në plan program dhe janë të mirorganizuar, por theksi duhet vënë në nevojshmërinë që paraqitet për përditësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së këtyre metodave. Mënyra më e mirë për të realizuar këtë gjë përcaktohet pikërisht nga feedback-u, që sigurohet nëpërmjet fazave të ndryshme të vlerësimit të performancës së studentëve. Vetëm në këtë mënyrë do të arrihen qëllimet dhe objektivat e përcaktuara nga ky program akademik qysh në fillim të krijimit të tij.

Institucioni në komentet e tij siguron se metodologjia e mësimdhënies do të ndryshojë sipas metodologjive bashkëkohore, gjë të cilën ne e vlerësojmë.

Përsa i përket transparencës së procesit akademik, i realizuar nëpërmjet përmbajtjes së programeve të çdo lënde të pasqyruar në kurrikulë, e vlerësojmë si të qartë dhe të përshtatshme.

Për këtë pikë Institucioni garanton se Strukturat përkatëse të Universitetit do të zgjidhin çdo ngërç të mundshëm gjatë rrugës së zhvillimit të procesit akademik.

Kriteri i pranimit të studentit në Ciklin e Parë të studimeve universitare është një çështje problematike, e cila kërkon vëmendje të veçantë. Në bazë të dokumentave që ne disponojmë studentët që pranohen në Studime në Gjuhën Shqipe, aktualisht kanë të drejtën për të vazhduar studimet e larta në Fakultetin e Filologjisë, pasi të kenë përfunduar shkollën e mesme. Ajo çka kishim rekomanduar ishte pikërisht aplikimi i një testi pranimi, si pjesë e rregullores së këtij Fakulteti, i cili do të testojë njohuritë e shkollës së mesme të studentit/es para se të pranohet në studimet e larta në këtë fushë studimi.

Lidhur me këtë rekomandim, Institucioni komenton se për këtë çështje paraqiten kriteret e vlerësimit, duke u përllogaritur në: 50% Testi i Maturës; 20% Mestarja e shkollës së Mesme dhe 30% Testi i Pranimit në Universitete. Kjo mënyrë pranimi e testimi është plotësisht në përputhje me standardet për pranimet në universitet të studentëve në këtë program studimi.

Personeli Akademik- Analizë dhe Rekomandime

Si një pikë e rëndësishme duhet vlerësuar dhe bashkëpunimi i secilit prej Fakulteteve me Departamentet e tyre përkatëse, duke patur parasysh faktin se këta të fundit janë bërthama e procesit të edukimit dhe mësimdhënies, si dhe kërkimit shkencor. Nga njëra anë, rritja e numrit të këtyre departamenteve duhet vlerësuar si një shtysë thelbësore për përmirësimin e arsimit të lartë, por, nga ana tjetër, rritja e numrit të pedagogëve të angazhuar me kohë të pjesshme nuk favorizon kërkimin shkencor dhe startegjinë e tij brenda këtyre departamenteve.

Përpara se të vijojmë me rekomandime konkrete lidhur me angazhimin e stafit akademik në përputhje me numrin e studentëve, vlerësojmë si një kërkesë të veçantë pajisjen me informacion të plotë të Organigramës së këtij Fakulteti. Sipas pohimeve të Institucionit aktualisht, në nivel universiteti, synohet të punësohen me kohë të plotë 47 pedagogë. Pjesa tjetër është e angazhuar me kohë të pjesshme. Mbështesim nismën për çeljen e konkursit të pranimit të 2 asistentë pedagogëve, si pjesë e këtij stafi akademik, por gjithashtu vihet re se 28 lëndë nga 42 në total janë përqëndruar vetëm në 5 lektorë. Vërejmë raste kur 1 lektori i ngarkohen deri në 7 lëndë. Për një shpërndarje të drejtë të ngarkesës mësimore si dhe ruajtjen e cilësisë së procesit të mësimdhënies rekomandojmë që 1 pedagogë duhet të ngarkohet me 2 deri në 3 lëndë, pasi një ngarkesë më e madhe ndikon negativisht në përfshirjen konkrete të tij në punë kërkimore-shkencore.

Në komentet e Institucionit garantohet rritja e numrit të pedagogëve të angazhuar me kohë të plotë në mënyrë që, të arrihet standardi 1 pedagogë për 18/20 studentë. Megjithatë kjo duhet verifikuar hap pas hapi nga KAA nëse do të plotësohet ky kriter.

Aktualisht në përbërjen e personelit akademik të Departmentit të Gjuhës Shqipe, sipas titujve janë: 5 profesorë doktorë; 1 profesorë asistentë, 6 doktorë dhe 10 master. Pa dyshim, kjo përbërje duhet vlerësuar si e kënaqshme. Megjithatë rekomandohet që pjesës së personelit akademik që ka titullin Master duhet t'i mundësohet hapësira dhe kushtet për të vazhduar Ciklin e tretë të studimeve doktorale. Përmirësimi i këësaj detyre do të çojë drejtëpërsëdrejti në përmirësimin e procesit mësimdhënës.

Lidhur me kërkesën tonë për mosparaqitjen e CV-ve të disa pedagogëve në plan program, në komentet e Institucionit sqarohet se ky personel akademik synohet të punësohet në të ardhmen. Ndërsa përsa i përket rekomandimeve për personelit akademik të brendshëm, ato pranohen dhe premtohet se do të respektohen në të ardhmen.

Vlerësojmë angazhimin e Fakultetit të Filologjisë, respektivisht Departamentin e Gjuhës Shqipe lidhur me organizimin e plan programit dhe strukturën e këtyre lëndëve, por rekomandojmë se duhet t'i jepet prioritet dhe rëndësi krijimit të një strategjie të kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Departamenti i Gjuhës Shqipe duhet të mendojë seriozisht lidhur me përfshirjen e personelit akademik në zhvillimin e një strategjie konkrete të punës kërkimore shkencore.

Në komentet e Institucionit lidhur me përfshirjen e stafit akademik në punë kërkimore-shkencore premtohet se Bordi Drejtues dhe Senati i këtij Institucioni do të zhillojnë një strategji të mirëfilltë kërkimore të cilën e kemi vlerësuar qysh në fillim të këtij raporti si faktori kryesor për njësitë bazë të çdo Universiteti që janë pikërisht Departamentet.

Megjithatë, për të patur një përfshirje më të madhe dhe produktive të studentit në kërkimin shkencor rekomandohet përmeshja e domosdoshme e nevojës për të patur një revistë të posaçme kërkimore-shkencore periodike, që të botohet nga vetë Departamenti i Gjuhës Shqipe. Kjo iniciativë mund të jetë fryt dhe i këtij bashkëpunimi ndërkombëtar, i kërkimit shkencor në universitet, i përfshirjes së studentit në projekte të ndryshme kërkimore etj. Sigurisht vlerësojmë dhe inkurajojmë vazhdimësinë e bashkëpunimit edhe në fushën e kërkimit, që ekziston midis këtij Institucioni dhe Universitetit të Prishtinës.

Në komentin e Institucionit lidhur me çështjen e sipërpërmendur theksohet vendosmëria për ta çuar përpara këtë nismë.

Lidhur me pohimet e Institucionit për të garantuar për mbushjen e standardit 3 m²/studentë dhe se një ndërtesë e veçantë parashikohet vetëm për Fakultetin e Filologjisë duhet të themi se vlerësimi ynë është pozitiv, por rekomandojmë të mendohet për të gjetur zgjidhje afatgjatë për t'u përballur më së miri dhe përmeshur kërkesat e të ardhmes.

Si elemente kyç të çështjes së Faciliteteve duhet vënë theksi pikërisht tek shërbimi dhe aksesimi në variantin elektronik të burimeve dhe literaturave që mundëson Biblioteka e këtij Institucioni. Vlerësojmë literaturën ekzistuese në Gjuhën Shqipe që ndodhet dhe mundësohet në këtë Fakultet, por duhet të themi se është e pamjaftueshme për t'u pajtuar me kërkesat e studentit dhe personelit akademik në të njëjtën kohë. Është konfirmuar dhe duhet përgëzuar bashkëpunimi midis Bibliotekës Kombëtare të Kosovës dhe asaj të Fakultetit, por rekomandojmë që ky akses elektronik i burimeve të literaturës bashkëkohore të mundësohet sa më parë si një komponent i rëndësishëm për përmirësimin në tërësi të procesit të edukimit dhe mësimdhënies.

Në komentet e Institucionit premtohen ndryshime dhe iniciativa të cilat vlejné për t'u parë dhe ndjekur hap pas hapi nga KAA, lidhur me mbajtjen e këtyre premtimeve.

Sigurimi i Cilësisë- Analizë dhe Rekomandime

Duke patur parasysh natyrën dinamike të kësaj fushe në Studime në Letërsinë Shqipe rekomandojmë vlerësimin e vazhdueshëm të programve që ky Institucion ofron. Vëmendje e veçantë duhet treguar në përputhjen e vlerësimit të jashtëm të programit me procesin e brendshëm të vlerësimit në mënyrë që të shmanget çdo mospërputhje e sigurimit dhe menaxhimit të cilësisë.

Lidhur me këtë çështje Institucioni bie dakord, duke premtuar se do ndjek me përpikmëri rekomandimin tonë.

Rekomandimet shtesë dhe të detajuara për përmbajtjen e çdo lënde janë dhënë lidhur me gabimet e dukshme gjuhësore të titujve të lëndëve të paraqitura në gjuhën angleze në Raportin vetvlerësues të këtij Institucioni.

Nëse ju nevojten detaje, i gjeni të përcaktuara qartazi në versionin në gjuhën angleze të këtij Raporti përfundimtar.

Përfundime

Në përfundim të këtij Raport Përfundimtar Vlerësimi, është e rëndësishme të theksojmë se disa prej çështjeve problematike të sipërpërmendura janë të riparueshme në kohë përpara se të fillojë viti akademik. Pa dyshim, zgjidhja e problemeve të tjera të mësipërme kërkon më shumë kohë.

Rekomandojmë akreditimin e programit të studimit Bachelor, në Studime në Gjuhën Shqipe për një periudhë prej tre vitesh, duke marrë në konsideratë ndryshimet që duhen realizuar lidhur me çështjet e trajtuara më sipër.